

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7581 E shtunë 7 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga KIÇO BLUSHI

Përse u këmbëngul me "përsheptim"  
shembja e Teatrit Kombëtar?



Për një shoqëri normale, goftë edhe  
kinse demokratike, do të mjaftonte  
shkrimi i A. Plasarit, klithma e  
Maks Velos "Unë jam Teatri", firma  
e falsifikuar ...  
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

Superleku dhe  
Banka e Shqipërisë

Nuk ka asnjë gjë të keqe nëse një  
monedhë kombëtare vlerësohet  
fort në tregun e këmbimit me  
monedhat e tjera, sidomos ato të forta  
(dollarë ...  
Vijon në faqen 21



Ndërroi jetë gjatë ndërhyrjes kirurgjikale

## Shtatzëna vdiq në muajin e nëntë, vihen nën akuzë 3 mjekët e QSUT

35-vjeçarja u transferua në 3 spitale brenda  
5 orëve. Bie akuzua për mjekët e maternitetit

Kur kanë kaluar rreth dy vite nga vdekja e Aida Çalkës  
bashkë me foshnjën e saj në maternitetin "Koço Glizheni"  
në Tiranë, tre mjekët të QSUT janë vënë nën akuzë nga  
prokuroria. Konkretisht organi i akuzës ka marrë si të  
pandehur mjekët e QSUT Besiana Hysi, Olvis Petre e Za-  
mira Hysenaj për 'mjekim ...  
Në faqen 10

LISTA E DYTE/ EMRAT E 1200 PRONAREVE QE NDAJNE 732 MILIONE LEKE

## KOMPENSIMI I PRONAVE, DOKUMENTET E APLIKIMIT

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, përfituesit në të gjithë vendin. Në  
datën 9 korrik rihapen aplikimet në Agjencinë e Trajtimit të Pronave



(Në foto) Ndërtime pa leje

Në faqet 6-7

APELI I OPOZITES

Basha, thirrje  
Metës: Teatri, mos  
ligjëro vjedhjen  
e kryehajdutit

Në faqen 3

KREU I QEVERISE

Edi Rama: Për  
një vit 28 mijë  
të punësuar, portal  
i ri për punësimin

Në faqen 4

RREGULLORJA

Praktika për  
farmacistët e  
rinj, dalin datat  
e regjistrimeve

Në faqen 11

"RUSI 2018"

Brazili thotë  
'lamtumirë', kampion  
bote shpallet një  
ekip nga Europa

Në faqen 22

NETET E NXEHTA



Serenata "live"  
dhe birra "Korça",  
si kalohet fundjava  
në qytetin juglindor

Në faqen 9



Diell, det dhe relaks, VIP-at e spektaklit shijojnë pushimet

## Fotot, Bleona Qereti rikthehet me bashkëshortin?

Era Istrefi tregon unazën në rrjetet sociale. Kledi Kadiu prezanton gruan

Nga PAMELA ALIAJ

Pas një heshtjeje të gjatë  
që nga ndarja nga me  
ish-bashkëshortin, nisën  
sërish thashethemet lidhur  
me këngëtares e njohur  
shqiptare, Bleona Qereti.  
Edhe pse tashmë kanë kalu-  
ar 4 vite që nga ndarja me



biznesmenin nga Kosova,  
Gani Bardha, së fundmi u  
përhapën sërish zërat për  
një ribashkim të tyre. Kjo ka  
qenë për shkak të postimit të  
një fotoje në 'Instastory'-n e  
saj ku shkruante edhe emrin  
e ish-bashkëshortit. Por sipas  
burimeve për ...  
Suplement

## VOTIMI NE KUVEND DEBATI


Zbardhet procesverbali i votimit, Tavo: Nuk isha në seancë, dikush votoi pro në vendin tim

# Ligji për teatrin, PD-LSI apel Ruçit: Votimi u manipulua, të anulohet

"Pati vjedhje votash, votuan deputetë pa qenë në sallë"

Valentina Madani

Opozita iu drejtua djeh me një kërkesë Kuvendit të Shqipërisë, përmes të cilës i kërkon anulimin e votimit të ligjit për Teatrit Kombëtar. Dy kryetarët e grupeve parlamentare të PD dhe LSI, Edmond Spaho dhe Petriti Vasili kërkojnë nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi të shpallë votimin të pavlefshëm, pasi sipas tyre në votimin e djeshëm kanë shënuar deputetë që nuk kanë qenë prezentë. Sipas tyre, "ky akt përbën një manipulim banditesk dhe vjedhje votash edhe brenda sallës së Kuvendit, nga po ata që me ligj po duan të vjedhin edhe pronën publike". "Votimi për teatrin është antikushitetues dhe nul. Vjedhje votash edhe në Kuvend, siç po vidhet prona e teatrit", shprehet opozita në kërkesën e saj. Opozita i referohet rastit të deputetit Vangjel Tavo. LSI akuzon socialistët për falsifikim të votimit për miratimin e ligjit për ndërtimin e teatrit të ri.



Faksimile e procesverbalit të votimit në Kuvend

### AKUZA

"Votimi për teatrin është antikushitetues dhe nul. Vjedhje votash edhe në Kuvend, siç po vidhet prona e teatrit", shprehet opozita në kërkesën e saj. Opozita i referohet rastit të deputetit Vangjel Tavo. LSI akuzon socialistët për falsifikim të votimit për miratimin e ligjit për ndërtimin e teatrit të ri.

## Kryemadhi paralajmëron Ramën: Vendimi për teatrin do ketë kurban

Heshtjen e kryeministrit Rama në parlament, ku po diskutohej ligji për teatrin, kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi e cilëson si frikë të kreut të qeverisë. Sipas saj, Rama e di mirë që ky vendim antikombëtar do të ketë kurbanin e tij një ditë. "Edi Rama heshti djeh për gjatë 12 orëve të seancës në parlament. Heshti sepse frika për vendimin e prishjes së teatrit është më e fortë se dëshira për t'iu kundërvënë opozitës. Heshti sepse më mirë se të gjithë kukullat e tij, ai e di se ky vendim antikombëtar do të ketë kurbanin e tij një ditë. Dhe ai që ka bërë kurban shokë e bashkëpunëtorë i trembet më shumë se të gjithë forcës së ligjit, që djeh e sot mungoi, por një ditë do të rëndojë mbi të gjithë ata që me votën e tyre shkatërru-



an njëren nga pak vlerat e kulturës dhe qytetarisë që kanë mbetur në Tiranë. Edi Rama heshti djeh në parlament me shpresën se nuk do të regjistrohet në procesverbalet e parlamentit si njeriu që ideoi dhe zbatoi shkatërrimin e Teatrit Kombëtar, duke harruar se sado të fshihet pas gishtit, sot të gjithë shqiptarët e kanë të qartë se përgjegjësia është vetëm e

### DEKLARATA

"Asgjë nuk e shpëton Edi Ramën nga përgjegjësia për shkatërrimin e teatrit, sikundër asnjë forcë shtetërore, policore apo fadrome nuk do mund të prishë Teatrin Kombëtar!", tha Kryemadhi.

tij. Sikundër është e qartë se qytetarët do ta mbrojnë teatrin me çdo kusht, me çdo formë e me çdo mënyrë", shprehet Kryemadhi. Sipas saj: "Asgjë nuk e shpëton Edi Ramën nga përgjegjësia për shkatërrimin e teatrit, sikundër asnjë forcë shtetërore, policore apo fadrome nuk do mund të prishë Teatrin Kombëtar!".

përsëritjen urgjente të votimit, përndryshe ai si institucion ka rënë juridikisht, politikisht dhe moralisht. Prokurorja e Përgjithshme të fillojë hetimin për këtë vepër penale shumë të rëndë të manipulimit të votimit par-

lamentar. Tanimë hajdutët e votave janë ulur këmbëkryq në parlament dhe në krye të qeverisë. Nëse prokuroria mbyll sytë edhe përpara kësaj, atëherë çdo qëndrim ndaj saj është plotësisht legjitim", shprehet kreu i deputetëve të

LSI-së. Vangjel Tavo nuk ishte në seancën e ditës së enjte, por në procesverbalin e votimit rezultoi se ai ka votuar pro ligjit të shumë debatuar. Mungesën e tij në seancë e konfirmoi vetë z.Tavo sipas të cilit: "Mungoja për



Seanca e fundit parlamentare

## Protestuesit duartrokasin Majkon: Nuk pranoi të bëhej partner në krim me Ramën

Qytetarë e artistë janë mbledhur sërish mbremë për të protestuar para teatrove kombëtarë. Ndonëse të enjten në parlament u miratua me 75 vota ligji që i hap rrugë shembjes së tyre për ndërtimin e një të vetmi trekatësh me Partneritet Publik Privat, qytetarët vijojnë protestën, të vendosur të qëndrojnë deri në fund për të mbrojtur atë që e quajnë godinën themel të kulturës shqiptare dhe një prej godinave më të bukura futuriste në vend. "Gjëma ndodhi në letër. Të mos e lëmë të ndodhë realisht. Majko, kryeministri i Shqipërisë në kohët më të vështira, me gjestin që bëri duke refuzuar votën për shembjen e teatrit i tregoi Ramës në pasqyrë fytyrën e tij", tha Çlirim Gjata. Ai argumentoi pse u bë me ligj kur mund të bëhej me VKM. "Sepse me VKM, ata do të mbanin përgjegjësi, ndërsa me ligj në parlament nuk mbajnë përgjegjësi". Ministrin e Diasporës, i cili la parlamentin duke refuzuar të votojë pro shembjes pas një debati me kryeministrin Rama, e falënderoi edhe Robert Budina. "Zoti Majko na bashkoi të gjithëve. Ne duhet ta falënderojmë atë. Kemi bërë gjithçka, sukcesi ynë ishte të bënim çdo gjë nga sindikata te protesta, nga takimi me politikanë e deri tek ardhja e politikanëve këtu. Kemi treguar qytetari", tha Budina. Ai premtosi se ditët në vijim protesta do të ndërrojë formë.



arsye shëndetësore. Nuk e di çfarë ka ndodhur. Dikush ka votuar me kartën time mesa duket. Karta nuk është send që merret me vete, por qëndron në tavolinën e gjithsecilit në Kuvend", - tha Tavo. Për këtë arsye, Edmond Spaho

dhe Petrit Vasili iu drejtuan me një letër Gramoz Ruçit, duke kërkuar anulimin e votimit. Kartë e çdo deputeti ndodhet në tavolinën e tij në Kuvend dhe në jo pak raste deputetë të ndryshëm i përdorin për të votuar.



A do i djegë opozita mandatat? Kreu i PD: Është opsioni më i lehtë, zhbëjmë parlamentin

# "Teatri", Basha thirrje Metës: Mos ligjëro vjedhjen e kryehajdutit

"Rama një taliban, përballemi në rrugë dhe sheshe"

Valentina Madani

Kreu demokrat, Lulzim Basha, paralajmëroi dje se opozita e bashkuar dhe mbarë qytetarët do të jenë përkrah artistëve për të penguar shembjen e godinës së vjetër të teatrit, pas miratimit të ligjit në Kuvend që i hap rrugë teatrit të ri. Para mediave, z.Basha e quajti si antikushetuese edhe krimin më të rëndë në 27 vite, miratimin e ligjit nga Kuvendi për ndërtimin e teatrit të ri. Sipas Bashës, Rama po pas-tron paratë e krimit dhe drogës me kulla në qendër të Tiranës. Sipas tij, në vendin ku ndodhet teatri sot, Rama ka parashikuar ndërtimin e 6 kullave. Basha e konsideroi Ramën si "peshk i madh", duke nënvizuar se teatri po shembet për të ndër-tuar 6 kulla betoni. Z.Basha i bëri thirrje Presidentit Ilir Meta të mos e dekretojë ligjin si dhe ambasadorëve që të mos heshtin. Krye-demokrati u shpreh se bete-ja për mbrojtjen e teatrit vazhdon dhe se parlamenti do të zhbëhet nga forca e njerëzve, duke u çliruar nga krimi. "Ai duhet të ndalet. I bëjmë thirrje presidentit të mos e dekretojë ligjin. Është antikushetues, ligjëron vjedhjen për të ndërtuar 6 kulla betoni. Qëllimi kryesor i projektit është pastrimi i parave të krimit dhe drogës", deklaroi kreu i PD-së. Në të kundërt paralajmëron përballje dhe masa ekstreme, siç është edhe djegia e mandateve të deputetëve të Partisë Demokratike. "Të jeni të sigurt se jemi të vendosur t'i ndjekim hap pas hapi të gjitha etapat dhe të miratim ligjin. Nëse nuk ka opozitë, do të marrë pjesë në seancat parlamentare. Opozita do t'i kërkojë gjithashtu presidentit që të mos e miratojë ligjin. Përballjen e fortë duket se demokratët do ta kenë në seancat e parlamentit, përballje që do të vazhdojë deri në largimin e Ramës. "Përballje deri në largimin e Edi Ramës. Ligji i teatrit është ligj terrorist", shprehen burimet. Mësohet se aksioni opozitar do të përqendrohet tek denonci-mi i aferave të qeverisë dhe moslejimi i seancave normale parlamentare. Ky vendim vjen pas miratimit të ligjit që i hap rrugë shembjes së Teatrit Kombëtar. Gjithashtu, në mbledhje është vendosur që deputetët e PD duhet të fokusohen në takime me qytetarët.



Kreu demokrat, Lulzim Basha

**AKUZA**

Kreu i PD-së pati një thirrje edhe për qytetarët: "Forca e vetme që ka Edi Rama është indiferenca dhe mosveprimi ynë. Së bashku, nuk ka njeri që e shemb teatrin. Sot krimi dhe korrupsioni është ligji i këtij vendi. Rama po e kthen Shqipërinë në një lavatriçe pastrimi parash. I bëj thirrje presidentit që të mos e dekretojë ligjin", deklaroi Basha.

**MANDATET**

"Të jeni të sigurt se jemi të vendosur t'i ndjekim hap pas hapi të gjitha etapat dhe opsionet, ku djegia e mandateve është opsioni më i lehtë. Përballja dhe çlirimi i parlamentit, çlirimi i Shqipërisë nga krimi është objektivi ynë dhe ne do ta arrijmë me të gjithë qytetarët", tha z.Basha.

## Basha paralajmëron arkitektin danez të teatrit: Do të jesh non grata në Shqipëri

Në një postim në "Twitter", kryetari i PD, Lulzim Basha ka paralajmëruar arkitektin danez të projektit të teatrit, Bjarke Ingels se do trajtohet si non grata në Shqipëri. Basha shprehet se arkitekti danez po kthehet në një bashkëpunëtor i vjedhjes së tokës së teatrit në Tiranë për interesat narkomafioze të Edi Ramës. "Bjarke Ingels është një bashkëpunëtor në grabitjen e tokës nga narkomafia e udhëhequr nga kryeministri Edi Rama, ndaj paralajmërohet: do të trajtohet si non grata nga komuniteti i artistëve dhe populli i Tiranës", shkruan Basha në "Twitter". Kreu i opozitës ka shpërndarë një artikull në anglisht të "exit.al", të cilët kanë verifikuar deklaratat e arkitektit danez mbi shembjen e Teatrit Kombëtar në Tiranë. Sipas investigimit, kompania e Bjarke ka gënjyer kur thotë se ka fituar konkurs për teatrin në Tiranë dhe nuk iu është përgjigjur gazetarëve. E njëjta gjë edhe me Bashkinë e Tiranës, e cila ka refuzuar të përgjigjet mbi procedurat për projektin e teatrit të ri. Investigimi zbulon se projekti është bërë për kompaninë "Fusha" sh.p.k dhe jo për Bashkinë e Tiranës apo për qeverinë shqiptare, duke mos pasur asnjë referencë masterplani për këtë zonë të qendrës së mbrojtur të Tiranës.

**SHEMBJA E TEATRIT**

## Vendimi i grupit, përballje në Kuvend deri në largimin e Ramës

Opozita do të bojkotojë komisionet parlamentare. Burime nga PD-ja bëjnë me dije se ky është vendimi i marrë në mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar, por nga ana tjetër, opozita do të marrë pjesë në seancat parlamentare. Opozita do t'i kërkojë gjithashtu presidentit që të mos e miratojë ligjin. Përballjen e fortë duket se demokratët do ta kenë në seancat e parlamentit, përballje që do të vazhdojë deri në largimin e Ramës. "Përballje deri në largimin e Edi Ramës. Ligji i teatrit është ligj terrorist", shprehen burimet. Mësohet se aksioni opozitar do të përqendrohet tek denonci-mi i aferave të qeverisë dhe moslejimi i seancave normale parlamentare. Ky vendim vjen pas miratimit të ligjit që i hap rrugë shembjes së Teatrit Kombëtar. Gjithashtu, në mbledhje është vendosur që deputetët e PD duhet të fokusohen në takime me qytetarët.

## "Votimi i ligjit, akt i paprecedentë e antikushetues"

## Shembja e teatrit, PDIU: Të vendosin qytetarët e Tiranës me referendum

PDIU propozoi dje referendum për çështjen e Teatrit Kombëtar. PDIU reagoi dje pas votimit në Kuvend, duke shprehur solidarizim me artistët dhe se për teatrin duhet të vendosin me referendum qytetarët e Tiranës. "PDIU solidarizohet me artistët dhe për teatrin duhet të vendosin me referendum qytetarët e Tiranës. PDIU është me teatrin, si një ndër simbolet e këtij qyteti. Simbole të tilla në çdo vend të botës ruhen e restaurohen, po mesa duket Teatri Kombëtar u trajtua si një simbol për t'u sulmuar dhe ndërkohë është një ndërtesë që kontraston me gjithë shëmti-



rat urbane të ndërtuara gjatë këtyre viteve të tranzicionit", thuhet në deklaratë. PDIU beson se për teatrin, e vetmja ndërtesë me shpirt e pamje në mes të Tiranës, e cila është pronë e shumë brezave dhe e qytetarëve të Tiranës do duheshin pyetur ata e jo pushteti i radhës. Për

të vendosur për teatrin do duhej të zhvillohej referendum, siç bën çdo qytet normal. "Por në vend të referendumit, ata që me arrogancë i kishin vënë syrin nënë me forcën e kartonëve aktin e paprecedentë e antikushetues për miratimin e një ligji të veçantë, për të përligjur prishjen e teatrit dhe rrëmbimin e pronës publike. Pikërisht për t'i dhënë fund vandalizmit e arrogancës së çdo pushteti përballë qytetarëve, PDIU bën thirrje të përsëritur që të ndryshojë ligji për referendumet, që do t'u mundësonte qytetarëve, demokracinë direkte për fatet e tyre", thuhet në deklaratën e PDIU.

askush nëse flisni nesër", u shpreh kreu i PD-së, Z.Basha njoftoi se opozita do të vijojë qëndresën për të shmangur shembjen e godinës teksa paralajmëroi se do ndjekin çdo rrugë për të ndaluar atë që e cilëson aktin më të rëndë të pastrimit të parave. "Edi Rama po e kthen Shqipërinë në një lavatriçe për pastrimin e parave të pista. I bëjmë thirrje presidentit të mos e ligjërojë vjedhjen. U bëjmë thirrje qytetarëve të

bëjnë qëndresë. Bashkë nuk ka njeri ta shembë teatrin", tha Basha. "Edi Rama po bën kulla e projekte betoni për të pastruar paratë e drogës", duke shtuar se, "ligji që kaloi Kuvendi është antikushetues dhe shkatërrim i rendit ligjor". "Akti i djeshëm është një ligj që ligjëron vjedhjen. I vetmi qëllim është grabitja e tokës në mes të Tiranës për të ndërtuar 6 kulla masive betoni. Nuk ka asnjë lidhje me artin e kul-

turën. Nuk bëhet për teatrin. Qëllimi kryesor i projektit është pastrimi dhe qarkullimi i parave të pista të drogës, krimit dhe korrupsionit. Siç ka raportuar OSBE para disa vitesh, vetëm nga korrupsioni i lejeve të ndërtimit, Edi Rama ka përfutur mbi 200 milionë euro. Imagjino sa ka fituar këto vite nga trafiku i drogës! Këto para nuk mbahen dot në thesë dhe nuk futen dot të gjitha në bankë", u shpreh Lulzim Basha.

## Ministri i Jashtëm: Nuk duam të zhgënjëm qytetarët shqiptarë

### Bushati për Euroactiv: Jemi në rrugën e duhur, gati për qershorin e ardhshëm

Edimë mirë se Shqipëria nuk është gati të bashkohet me BE-në nesër. Kemi shumë punë për të bërë në radhë të parë. Por do të jemi gati për të parashtruar pozicionin tonë në fillimin e procesit të zgjerimit në qershorin e ardhshëm", është shprehur dje për Euroactiv, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati. "E dimë dhe jemi dakord me partnerët tanë evropianë që do na duhet të vazhdojmë programin tonë të reformave, të cilat forcojnë sundimin e ligjit dhe trajtojnë çështjet e korrupsionit dhe krimin të

organizuar. Qeveria shqiptare ka bërë tashmë një progres të konsiderueshëm në reformimin e administratës publike, ristrukturimin institucional të gjyqësorit, si pjesë e planit tonë më të gjerë për reformën e drejtësisë, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e bash-

këpunimit me organet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit", tha më tej ministri. "Qeveria jonë nuk po ndjek reformat, sepse Bashkimi Europian e kërkon atë. Ne po i ndërmarrim këto ndryshime gjithëpërfshirëse në sistemin tonë, sepse njerëzit tanë meritojnë më mirë. Shqiptarët meritojnë të jetojnë në një shoqëri më të drejtë, një vend

më të drejtë dhe të qëndrueshëm, ku korrupsioni nuk dobëson ekonominë tonë dhe nuk minon demokracinë tonë. Shqiptarët e zakonshëm duhet të jenë ata që përfitojnë nga programi ynë i reformës dhe nuk mund t'ia lejojmë vetës që t'i zhgënjëm", shtoi Bushati më tej. "Ne jemi në rrugën e duhur drejt një demokracie më të drejtë dhe



më të shëndetshme në Shqipëri. Është një rrugë e gjatë që shtrihet para nesh, por qytetarët shqiptarë me të drejtë presin që ne të japim rezultate. Ne nuk

mund t'ia lejojmë vetës t'i zhgënjëm dhe me mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë evropianë, do të kemi sukses", u shpreh Bushati në fund.

Kryeministri, me krerët e zyrave të punës: Nuk ka shkarkime, realizuat objektivat

# Edi Rama: 28 mijë të punësuar, portal kombëtar për vendet e punës

"Në shumë biznese, punonjësve nuk u jepen të drejtat"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama propozoi dje krijimin e një 'websit'-i kombëtar për vendet e lira të punës, i cili do të shërbejë si një mekanizëm ndihmës për punëkërkuessit dhe bizneset. Këtë propozim Rama e bëri dje në takimin me drejtoritë rajonale të punësimit. "Na duhet patjetër ky mekanizëm i aksesueshëm nga i gjithë publiku dhe transparent e i detyrueshëm për kompanitë që të publikojnë vendet e lira të punës në këtë 'ebsitë' kombëtar", - tha kryeministri. Ai kërkoi që kjo ide të çohet përpara dhe të zbatohet. "Nuk do të jetë e lehtë, por është e domosdoshme", - tha Rama. Gjatë fjalës së tij, në këtë takim Rama tha se të gjitha zyrat kanë realizuar objektivat, një pjesë e tyre kanë tejkalime të rëndësishme dhe një pjesë tjetër kanë tejkalime që kanë kaluar çdo parashikim. "Më vjen mirë që për të disatin muaj rresht nuk ka arsye që askush prej jush të largohet nga detyra, përdërisa e kemi bërë të qartë që kush realizon objektivin e muajit, jo vetëm që është i sigurt në punën e tij, por meriton të gjithë vlerësimin për punën. Përgëzoj në mënyrë të veçantë zyrën e Beratit, zyrën e Skraparit, po ashtu, pavarësisht se në numra absolutë janë numra më të vegjël, por në realitet rezultatet janë qartësisht të dukshme në raport me numrin e kërkuar, zyrën e Gramshit, zyrën e Librazhdit, zyrën e Peqinit, zyrën e Gjirokastrës. Për të disatën herë Gjirokastra mbetet në listën kryesore të zyrave me arritje të larta, zyrën e Përmetit dhe të Tepelenës, që këtë herë kanë arritje vërtet për t'u përgëzuar, zyrën e Korçës, të Kolonjës dhe të Pogradecit, zyrën e Kukësit, që ka një rezultat jashtëzakonisht pozitiv dhe meriton respekt për punën e kryer, të Hasit. Po ashtu, të Lezhës, zyrën e Mirditës, zyrën e Pukës, që ka ndikuar



Kryeministri Edi Rama gjatë takimit të djeshëm me krerët e zyrave të punës

ndjeshëm edhe në performancën e përgjithshme për Shkodrën, zyrën e Delvinës dhe zyrën e Sarandës", theksoi Rama. "Më vjen shumë mirë po ashtu, që duke iu referuar sistemit tonë të taksave, pra emër për emër për çdo person të punësuar nga

maji i vitit të kaluar në këtë qershor, ne kemi 28 324 të punësuar më shumë, formalisht dhe në sektorin jobujqësor", bëri të ditur Rama. Sipas tij, këtë 6-mujor janë punësuar 14 593 persona. "Në 6-mujor kemi 31 237 vende pune të shpallura.

Pra, nëse vendosim bazën krahasuese mes punësimeve të bëra prej nesh dhe vendeve të punës së shpallura, ka akoma hapësirë për të shtyrë fort dhe për të thithur më shumë njerëz në tregun e punës", shtoi kryeministri. Ai kërkoi që

#### TAKIMI

Kryeministri Edi Rama ndodhet në Sofje të Bullgarisë, ku po zhvillohet samiti në kuadër të nismës së qeverisë kineze të bashkëpunimit me Europën Qendrore dhe Lindore, e njohur ndryshe edhe si 'Nisma 16+1'. Ai u takua atje me kryeministrin e Kinës, Li Keqiang. Fokusi i takimit ishte programi i bashkëpunimit mes dy vendeve dhe projektet konkrete në bujqësi, turizëm, infrastrukturë ujore e portuale, por edhe kulturë.

drejtorëve të zyrave të punës. "Roli juaj duhet të forcohet në raportet me Inspektoratin e Punës dhe me Drejtorinë e Tatimeve, në funksion të garantimit të një shërbimi sa më të mirë nga këto të dyja për biznesin. Zyrat e punës duhet të jenë të parat të interesuara që biznesi të mos cenohet as nga Inspektorati, as nga Tatimet. Nga ana tjetër, edhe për të garantuar punonjësit në raport me kushtet, në raport me rregullat. Nëse ne si shtet përmes zyrave të punës bëhemi ndërmjetës për punësimin, arrijmë punësimin, duhet të marrim edhe përgjegjësinë e garantit që po i punësojmë njerëzit në kushte ligjrisht normale, që është një tjetër pjesë e vështirë, sepse ne e dimë shumë mirë që në shumë biznese nuk respektohen rregullat ligjore, nuk u jepen punonjësve të gjithë ato të drejta që u takojnë me ligj", tha Rama.

Helikopterët 'Cougar' të Forcës Ajrore janë pajisur me kova të reja për shuarjen dhe lokalizimin e zjarreve në terrene të vështira. Kovat e reja me kapacitet 2500 litër secila rrisin me 12 herë kapacitetin e Forcave të Armatosura në krahasim me 1 vit më parë kur për shuarjen e zjarreve nga ajri, kontraktotë shërbimi privat. Rritja e kapaciteteve falë mjeteve të reja të montuar në helikopterë mundësohet edhe përmes orëve më

## Helikopterët 'Cougar', kapacitet 12 herë më i lartë se 1 vit më parë

### Emergjencat Civile në Ministrinë e Mbrojtjes, Xhaçka: I domosdoshëm rikonceptimi i tyre

të mëdha të fluturimit, që mundësojnë helikopterët 'Cougar'. Për futjen në përdorim të pajisjeve të reja u krye një demonstrim në liqenin e Farkës, i cili u ndoq nga afër nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, sho-

qëruar më pas me një mungësi pune për Emergjencat Civile me prefektët e qarqeve, strukturat e Forcave të Armatosura që angazhohen në këto situata, si edhe deputetët e Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Ministrja

Xhaçka foli për avantazhet që sjellin në përballimin e zjarreve pajisjet e reja, pa harruar të përmendë djemtë dhe vajzat që angazhohen në terren në rastet e emergjencave. Ajo kërkoi angazhim më të madh nga pushteti lokal,

duke filluar që nga buxheti i bashkive, të cilat duhet të parashikojnë fonde për Emergjencat Civile. Ministrja Xhaçka e cilësoi ligjin e ri të emergjencave civile si një reformë të mirëfilltë ligjore, administrative, operacionale dhe strukturorë. "Vlerësojmë si të domosdoshme, së pari, të rikonceptojmë sistemin e Emergjencave Civile, duke e përshtatur menaxhimin e tyre me strukturën dhe rolin e ri në kuadrin e Ministrisë së Mbrojtjes", tha ajo.

Në tre muajt Prodhimi i Brendshëm Bruto u rrit me 4.45%, kontribuoi energjia

Ornela Manjani

# Forcimi i lekut "goditi" buxhetin, Ahmetaj: Arkëtuam 3.6 mld lekë më pak

Nga 1 prilli bizneset me xhiro vjetore mbi 2 mln lekë janë në TVSH

**F**orcimi i lekut dhe rritja e masës së rimbursimeve janë dy arsye kryesore që ka shkaktuar arkëtimin e më pak të ardhurave në buxhet në 6 muajt e parë të vitit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, theksoi se goditja që i ka dhënë mbicimi i lekut buxhetit të shtetit, ka qenë rreth 3.6 miliardë lekë. Ndërsa bëri një panoramë të ecurisë ekonomike të vendit për gjysmën e parë të vitit, Ministri Ahmetaj bëri me dije se pavarësisht rënies së euros të ardhurat nga doganat u regjistruan në 3.3 miliardë lekë më shumë. Ahmetaj foli edhe për lehtësirat fiskale ndaj bizneseve, ku theksoi se në vjeshtë pritet një tjetër paketë në mbështetje të sipërmarrjes. Disa ligje fiskale që lehtësojnë barrën e bizneseve dhe nxitin zhvillimin e tyre pritet të votohen në parlament javën e ardhshme.

**ANALIZA E MINISTRIT**

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj mbajti konferencë për shtyp mbi zhvillimet e fundit ekonomike në vend. Gjatë fjalës së tij, Ahmetaj tha se vijon besimi tek rritja ekonomike. Për tremujorin e parë të 2018-s sipas IN-STAT, Prodhimi i Brendshëm Bruto shënoi një rritje prej 4.45%, ku kontributin kryesor e dha energjia. Ahmetaj u ndal edhe tek efekti që ka pasur përfshirja e biznesit të vogël në skemën e TVSH-së, ku nga të gjitha studimet e ekspertëve për ndryshimin e çmimeve është vënë re se indeks i çmimeve për njësitë tregtare të marra në studim nuk është ndikuar nga përfshirja e tyre në skemën e TVSH. Prej datës 1 prill të gjithë bizneset që kanë një xhiro vjetore më të madhe se 2 milionë lekë janë të përfshirë në skemën e TVSH-së. Përpara një prillit pragu për përfshirjen në skemën e TVSH ishte një xhiro vjetore më e madhe se 5 milionë lekë. Gjatë fjalës së tij për para mediave, ministri Ahmetaj u ndal edhe tek eksportet. Duke iu referuar të dhënave Ahmetaj tha se eksportet u rriten 18.4%. "Këtë kemi parë në muajt e fundit me gjithë lëvizjen në kursin e këmbimit eksportet janë rritur që do të thotë eksportet kanë rritur produktivitetin dhe kemi një rritje 7% të importeve. Edhe pse me gjithë goditjen që kanë marrë nga luhajtjet e kursit të këmbimit," - shtoi ministri Ahmetaj. Një tjetër pikë që preku kreu i Financave është edhe rritja e numrit neto të bizneseve në vend. "Rritja e bizneseve neto, sipas statistikave zyrtare, duke marrë efektin neto, pra sa u krijuan dhe sa u mbyllen,



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

tregon që ka një rritje për periudhën janar-qershor prej 7 mijë biznese të reja", përfundoi ministri Ahmetaj. Për sa i përket emetimit të Eurobondit, ministri u shpreh se nëse do të vendosim të dalim në treg

do të jetë një rezultat pozitiv. Pyetjes së gazetarëve si do të procedohet me taksen e pronës ministri u përgjigj se në 1 janar 2019 ka vetëm një metodologji dhe taksa vazhdon të mblidhet. Gjithashtu, ministri shtoi se janë

në një proces zyrtar të skanimit me kontratën e aeroportit dhe shumë shpejt presin që të kenë rezultate me ministrin e infrastrukturës me një urdhër zyrtar dhe kanë filluar inspektimin e detajuar.

## Lojërat e fatit përplasnin Braçen me Ahmetajn, deputeti: Të ikin nga lagjet deri në fund të vitit

**K**omisioni parlamentar i Ekonomisë është shoqëruar këtë të premte nga debate, ndonëse opozita nuk ka qenë e pranishme. Deputeti Erion Braçe dhe ministri i Financave, Arben Ahmetaj debatuan për çështjen e pikave të lojërave të fatit. Sipas Braçes, ato du-

het të largohen nga lagjet dhe afati është deri në fund të muajit dhjetor. "E kam shumë të vështirë të dëgjoj akuzat të rreme nga kjo ana që mungon. Në fund të këtij viti përfundon afati për mbylljen e lojërave të fatit. Po mirë mo, jam i lumtur që keni për këtë vullnet, por duhen marrë masat që ky aksion të

mbyllet në dhjetor 2018, që në 1 janar 2019, lojërat e fatit të zhduken nga çdo fund pallati, bodrum pallati, e të shkojnë aty ku e kanë vendin"-tha Braçe në komision. Ministri i Financave ka deklaruar se ky vendim nuk shtyhet. "Nuk shtyhet... Po mo po, kryetar"-tha Ahmetaj.



## Sinjalistika rrugore

ARRSH hap tender 208 mln lekë, ja akset ku do ndërhyhet

**A**utoriteti Rrugor Shqiptar planifikon të ndërhyjë në përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale, në disa prej akseve në veri të vendit. Vlera e vënë në dispozicion është 208 milionë lekë dhe financohet nga buxheti i shtetit, ndërkohë që pas përzgjedhjes së firmës fituese nga procedura e prokurimit, punimet pritet të zgjatën për një periudhë 8-mujore. Segmentet rrugore ku do të ndërhyhet janë: Ura-Fierzë- Bajram Curri, Balldren-Bushat, Laç-Patok dhe Koplík- Qafë Thore. Ndërkohë që, kompanitë e interesuara mund të dorëzojnë ofertat e tyre deri në datën 6 gusht. Referuar specifikimeve teknike të vendosura nga Autoriteti Rrugor Shqiptar saktësohet se të gjitha materialet që do të përdoren për përmirësimin e sinjalistikës duhet të jenë të klasit të parë. Kjo në një kohë kur nuk kanë munguar kritikat për mungesë cilësie në materialet e përdorura, kryesisht në sinjalistikën horizontale që ka të bëjë me vijëzimet e rrugës. Kompanitë e kontraktuara janë kritikuar për materiale jo cilësore, çka nuk siguron jetëgjatësinë e punimeve. Akuzat nuk kanë munguar as në drejtim të institucioneve për mosmonitorim të punimeve, çka i detyron më pas të shpenzojnë disa herë për këtë shërbim apo të lenë akset rrugore pa sinjalistikën e domosdoshme.

## Banka do të rritë investimet për infrastrukturën publike

### BERZH, investime 1 mld euro për 80 projekte në vend

**B**ERZH ka investuar bpothuajse 1 miliard euro në mbi 80 projekte në Shqipëri. Kështu bëri të ditur kreu i zyrës së BERZH në Shqipëri, Matteo Colangeli për SeeNews. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do të vazhdojë të investojë në ngushtimin e hendekut infrastrukturor në Shqipëri, i cili mbetet i rëndësishëm në aspektin e lidhjeve të transportit, energjisë, infrastrukturës komunale dhe mjedisore, sipas tij. "Ne do të vazhdojmë të maksimizojmë mundësitë për të fi-

nancuar infrastrukturën publike përmes mjeteve komerciale sa herë që të jetë e mundur", tha në një intervistë me SeeNews Colangeli. Ai shtoi se kohët e fundit BERZH ka shpërndarë 117 milionë euro të huas së saj për kompaninë shqiptare të prodhimit të energjisë KESH dhe 100 milionë eurosh mund të pasojë në muajt e ardhshëm. "Po punojmë edhe për një kredi tjetër sovranë prej 50 milionë dollarë për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale. Rritja e mbështetjes sonë për NVM-të është një tjetër

prioritet kyç në Shqipëri. Ne po punojmë me bankat vendase për të thelluar arritjen tonë në sektorin privat duke shkëmbyer rrezik me ta," - tha kreu i zyrës së BERZH-it në Shqipëri, duke përkthyer projektet me interes për bankën. Colangeli tha, gjithashtu, se BERZH po rrit aktivitetin e saj të investimeve në Shqipëri në vitin 2018. Projekti kyç këtë vit do të jetë financimi i projektit TAP, në Shqipëri. "Bëhet fjalë për një kredi deri në 1.2 miliardë euro, me 500 milionë euro nga fondet tona dhe pjesa tjetër edhe



nga bankat komerciale. Ky do të jetë investimi ynë më i madh në vend deri më sot," - vuri në dukje ai. Më 4 korrik, bordi i drejtorëve të EBR miratoi një kredi deri në 500 milionë euro për ndërtimin e TAP. Tubacioni i gazit do të shtrihet nga kufiri i Greqisë me Turqinë,

nëpërmjet Shqipërisë dhe përgjatë detit Adriatik, në bregun italian. Konsorciumi TAP tha më parë këtë javë se ka implementuar në tokë rreth 85% të tubave në rrugën në Shqipëri dhe Greqi. Konsorciumi planifikon të fillojë operimin në shkallë të plotë të tubacionit në vitin 2020. BERZH po mbështet, gjithashtu, krijimin e një sektori të mirë të gazit duke ofruar asistencë teknike për të ndërtuar kapacitetet në operatorin e sapo krijuar të sistemit të transmisionit të Shqipërisë, Albaz. Nga ana tjetër, BERZH dhe BE janë duke strukturuar një program gjithëpërfshirës në mbështetje të rritjes së konkurrencës së industrisë së turizmit në Shqipëri. Programi do të financohet nga BERZH nëpërmjet një kredie sovranë deri në 60 milionë euro dhe një grant nga BE prej 40 milionë euro.

Agjencia hap procedurat për aplikim, 6 dokumentet që duhet të dorëzoni

# Lista e re e ATP-së, 1200 pronarët që marrin paratë

## Fondi 732 milionë lekë, aplikimi nis në 9 korrik

Ornela Manjani

Miratohet fondi për kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtime pa leje. Fondi arrin në 732 milionë për sipërfaqe prej 43 965 m<sup>2</sup>. Në total janë rreth 1200 pronarë që do të marrin paratë për tokën. Lista është publikuar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, e cila bën të ditur se 9 korrik nisin procedurat për dorëzimin e dokumenteve. Përfituesit janë në Tiranë, Kamzë, Vorë, Elbasan, Durrës, Fshatra Turistikë dhe Sh-

kodër. Vendimi është marrë në mbledhjen e këshillit të ministrave dhe në pikën 2 të tij thuhet se "masa e kompensimit është 43 965,31 m<sup>2</sup> dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 731 847 186,22 lekë". Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare dhe pronarët duhet të presin vetëm çeljen e procedurave për aplikim nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për të dorëzuar dokumentet e më pas për të marrë paratë.

### APLIKIMI

"Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituese do të fillojë në datën 09/07/2018 dhe nuk do të jetë

i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjithë subjektet e interesuara, të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën Rruga "Muhamet Gjollësia", Nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte, për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatës". Thuhet në njoftimin e ATP-së. Sipas njoftimit subjekti kërkuar (subjekti përfitues/trashëgimtari ligjor/përfaqësuesi me prokurë), në momentin e plotësimit të kërkesës për kompensim, duhet të paraqesë gjashtë dokumente. Për të përfituar kompensimin për tokën e

zënë nga ndërtime pa leje duhet të paraqesin në ATP kërkesë për kompensim në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtime informale (ALUIZNI). Pronari plotëson një kërkesë për kompensim në vlerë sipas formatit Tip që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për

### DOKUMENTET

1. Kërkesën për kompensimin e pronës, sipas formatit tip, që i vihet në dispozicion nga ATP;
2. Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil;
3. Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo kërkesë të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 mijë lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme;
4. Vërtetimin original të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;
5. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
6. Mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 mijë lekë.

testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit

të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar.

### LISTA ME 1200 PRONARËT

799	SHEMSI	QAZIM	CURRI	2,459,622.80
800	SHEMSI	QAZIM	CURRI	993,039.20
801	LILA	SULEJMAN	KARAJ	
802	FATIME		KARAJ	
803	ENGJELLU		KARAJ	
804	ISUF		KARAJ	985,380.80
805	ABDYL	QAMIL	KACOLLJ	
806	ALBERT	QAMIL	KACOLLJ	
807	ELISABETA	QAMIL	KACOLLJ	
808	RUZHDI	QAMIL	KACOLLJ	9,872,954.00
809	SHEJNAZE	QAMIL	KACOLLJ	
810	SKENDER	QAMIL	KACOLLJA	
811	SUZANA	QAMIL	KACOLLJ	
812	GURRIJE	RAKIP	BELLEGU	6,059,070.80
813	KADRI	SEIT	MUÇKA	6,272,229.60
814	HYSEN	IBRAHIM	NEZIRI	6,020,778.80
815	BEHEXHET	RYZHDI	HASEQIU	
816	FLORA	RYZHDI	KREKA	
817	ALMA	RYZHDI	PALLUQI	
818	BRUNO	SHEREF	VERDHI	15,541,446.40
819	AGRON	TEKI	TELA	
820	ANITA	MASAR	ALICKA	
821	BULENT	TEKI	TELA	
822	EDMOND	TEKI	TELA	
823	FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ	
824	GJERAK	MAZLLEM	KARAISKAJ	
825	HAJALI	ISMAIL	YPI	
826	LAVDIJE	SKENDER	KALASA	
827	NEBI	ISMAIL	SEFA	
828	SHAZIVAR	MASAR	KARAOSM	
829	SHEGUSH	MASAR	KOSOVA	
830	SUHELA	XHEVDET	LIBOHOVA	
831	TEUTA	SKENDER	FORA	
832	NESEFIJE	TEKI	SELENIC	4,472,505.60
833	SELMAN	TAHIR	BELSHAKU	3,614,764.80
834	AGRON	TEKI	TELA	
835	ANITA	MASAR	ALICKA	
836	BULENT	TEKI	TELA	
837	EDMOND	TEKI	TELA	
838	FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ	
839	GJERAK	MAZLLEM	KARAISKAJ	

840	HAJALI	ISMAIL	YPI	
841	LAVDIJE	SKENDER	KALASA	
842	NEBI	ISMAIL	SEFA	
843	NESEFIJE	TEKI	SELENIC	
844	SHAZIVAR	MASAR	KARAOSM	
845	SHEGUSH	MASAR	KOSOVA	
846	SUHELA	XHEVDET	LIBOHOVA	
847	TEUTA	SKENDER	FORA	
848	XHANETA	ISMAIL	PRODANI	
849	NESEFIJE	TEKI	SELENIC	10,580,079.60
850	KONSTADIN		PAPANIK OLLA	17,367,974.80
851	MAKBULE	QAZIM	BALA	
852	ISMET	RIZA	XHEPA	
853	XHEMAL	QAZIM	XHEPA	
854	ZENEPE	QAZIM	ZALLA	
855	RAJMONDA	VELI	KASMI	1,067,070.40
856	NURI	RIZA	XHEPA	
857	REZAR	RIZA	XHEPA	
858	ILIRJANA	MUSA	BASHA	
859	LUAN	SULEJMAN	STRINGA	
860	AIDA	MAUSA	MEÇA	
861	MUSA	MUSTAFA	XHEPA	
862	AIDA	FEJZULLA	MIRAKU	
863	AIDA	URAN	VYSHKA	
864	EMINE	FEJZULLA	KAPERCEL	
865	FATIME	XHAFERR	VYSHKA	
866	FEJZULLA	URAN	VYSHKA	
867	AGRON	XHEVDET	SKILJA	
868	ALI	XHEVDET	MIRAKU	
869	GJYSINA	FEJZULLA	MIRAKU	
870	ISMAIL	XHEVDET	MIRAKU	
871	ISUF	XHEVDET	SKILJA	
872	MARLENA	FEJZULLA	MIRAKU	
873	MEHMET	XHEVDET	MIRAKU	
874	MELEQE	XHEVDET	SKILJA	
875	MITHAT	XHEVDET	SKILJA	
876	PLATON	XHEVDET	MIRAKU	
877	RUKIJE	XHEVDET	MIRAKU	
878	VJOLLCA	XHEVDET	SKILJA	
879	ZYHRA	XHEVDET	MIRAKU	
880	DRITA	FEJZULLA	VYSHKA	

881	HAJRIE	FEJZULLA	VYSHKA	2,077,979.20
882	YMER	SALI	MULLAYEV	2,259,228.00
883	AGIM	QAZIM	HASEQIU	
884	ARTA	ASHKI	HASEQIU	
885	ELIDA	MEHMET	HASEQIU	
886	FATMIR	HAKI	HASEQIU	
887	FERDINAN	HAKI	HASEQIU	
888	HYSEN	MEHMET	HASEQIU	
889	LEONORA	ASHKI	HASEQIU	
890	LUAN	HAKI	HASEQIU	
891	MERITA	ASHKI	HASEQIU	
892	MIMOZA	MEHMET	HASEQIU	
893	NIMETE	MEHMET	HASEQIU	
894	QAZIM	ASHKI	HASEQIU	
895	SHAHU	HAKI	HASEQIU	
896	VALENTIN	ASHKI	HASEQIU	
897	VERONIKA	ASHKI	HASEQIU	
898	ENEA	FERDINAN	HASEQIU	4,535,049.20
899	BEHEXHET	RYZHDI	HASEQIU	5,002,211.60
900	BRUNO	SHEREF	VERDHI	
901	MAJLINDA	DILAVER	DUHANXH	
902	ADRIAN	DILAVER	SEJDIRI	
903	BEKIM	RIFAT	KADIU	
904	ZAMIRA	IBRAHIM	VYSHKA	7,375,039.20
905	SILVANA	SHUAIP	DRAÇINI	
906	ARTAN	KARAFIL	KURTI	
907	BARDHUL	HYSEN	DAKLI	
908	BESA	YLBER	DAKLI	
909	BURBUQE	HYNSI	KOTHERJA	
910	DRITA	HYSEN	DAKLI	
911	ELONA	KUJTIM	DAKLI	
912	HYQMET	HYNSI	KOTHERJA	
913	HYNSI	LUAN	KOTHERJA	
914	IBRAHIM	HYSEN	DAKLI	
915	LAURESHA	KUJTIM	DAKLI	
916	MIRELA	SHUAIP	DRAÇINI	
917	RUKIELA	KUJTIM	DAKLI	
918	RUZHDIJE	HYSEN	DAKLI	
919	SAMI	HYSEN	DAKLI	
920	SHPRESA	HYSEN	DAKLI	
921	VALENTIN	HAJDAR	DAKLI	
922	MINERVA	ZYHDI	KOTHERJA	
923	DRITA	HYSEN	DAKLI	3,131,009.20
924	AGIM	QAZIM	HASEQIU	



Prokuroria: Mjekim i pakujdesshëm

# Vdekja e Aida Çajkës me foshnjën në maternitet, vihen nën akuzë tre mjekë të QSUT

Kur kanë kaluar rreth dy vite nga vdekja e Aida Çajkës bashkë me foshnjën e saj në maternitetin "Koço Glizheni" në Tiranë, tre mjekë të QSUT janë vënë nën akuzë nga prokuroria. Konkretisht organi i akuzës ka marrë si të pandehur mjekët e QSUT Besiana Hysi, Olvis Petre e Zamira Hysenaj për mjekim të pakujdesshëm. Prokuroria ka kërkuar, gjithashtu, të pushohet akuzat për tre mjekët e maternitetit "Koço Glizheni" të ndaluar pak kohë më parë. Sipas ekspertizës, ndaj nënës së dy fëmijëve, që priste të sillte në jetë një të tretë nuk është treguar kujdesi i duhur mjekësor. "Mjekët e neglizhuan trajtimin e shtatzënës. Çakja u transferua në tre spitale brenda 5 orëve. Gabuan mjekët në tre spitalet që 35-vjeçarja u transferua"-thanë ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Tiranë pak kohë më parë. Sakaq prokuroria ka dorëzuar dosjen në gjykatë dhe seanca paraprake pritet të mbahet më datë 17 korrik.

## NGJARJA

Ngjarja ndodhi më 16 shtator 2016, ku 35-vjeçarja nga Paskuani ka humbur jetën gjatë lindjes bashkë me foshnjën. Mësohet se në këtë datë rreth orës 05.00 në Spitalin-Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Glizheni" është konstatuar vdekja e pacientes Aida Çajka dhe e fëmijës së saj seksi femër. E ndjera çajka, e cila ishte në muajin e 9 të shtatzënisë, është paraqitur në datë 15.09.2016 rreth orës 22.30 në Spitalin-Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Glozheni" në gjendje të rëndë shëndetësore e shoqëruar nga të afërmit e saj. Në vijim, e ndjera është vizituar nga mjekët obstetrik-gjinekolog, të cilët, pasi janë konsultuar ndërmjet tyre, pavarësisht gjendjes së rëndë të pacientes, e kanë dërguar pacienten për një kontroll në QSUT për konsultë kardiologu. Pas vizitës së bërë nga kardiologu, e ndjera është dërguar në SU Shefqet Ndroqi, për vlerësim nga pneumologu, ku pas vizitës është dërguar përsëri në Spitalin-Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, "Koço Glizheni" në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. Pas mbërritjes në Spitalin-Universitar Obstetrik-



Viktima Aida Çajka



## Prokuroria

### HETIMI

Prokuroria ka vënë nën akuzë tre mjekë të QSUT, për vdekjen e Aida Çajkës bashkë me foshnjën e saj në maternitetin "Koço Glizheni" në Tiranë më shtator të 2016-ës. Organi i akuzës ka marrë si të pandehur mjekët e QSUT Besiana Hysi, Olvis Petre e Zamira Hysenaj për mjekim të pakujdesshëm. Sipas ekspertizës, ndaj nënës së dy fëmijëve, që priste të sillte në jetë një të tretë, nuk është treguar kujdesi i duhur mjekësor.

Gjinekologjik "Koco Glozheni" rreth orës 04.00 në gjendje shumë të rëndë, e ndjera i është nënshtruar ekzaminimeve nga ku ka rezultuar se fetusit (fëmija) ishte i vdekur. Nga mjekët është inicuar një ndërhyrje kirurgjikale, por 35-vjeçarja ka ndërruar jetë gjatë kësaj ndërhyrjeje. Familjarët e viktimit, akuzojnë mjekët për vdekjen e saj. Ata thonë se i kanë sorollatur gjithë natën sa në urgjencën e QSUT e sa në Sanatorium derisa ajo nuk ka mundur më të rezistojë dhe ka ndërruar jetë. Më herët vëllai i të ndjerës, tregoi me detaje ngjarjen, që e sëmura hyri në maternitet e deri kur mori lajmin e vdekjes. Ai tregon se

motra nuk ka pasur asnjë shqetësim gjatë shtatzënisë. Duke folur për trajtimin në maternitet, Fationi tregon se pasi është futur në spital i kanë kërkuar që ta dërgojnë në QSUT pasi motra e tij mund të kishte probleme me zemrën. "Nuk është e vërtetë që është futur direkt në operacion. Kur motra hyri për t'u operuar nuk po më informonin. Pres disa minuta dhe më pas doktori më tha gjendja është shumë e rëndë. Kur e pyeta sa është probabiliteti që të shpëtojë më tha jemi me minus. Ka përqindje minus tha që të shpëtojë. Po çfarë po presim i thashë. Po presim një specialist të shprekës që çfarë mund të bëjmë", tregoi Fationi, vëllai i të ndjerës.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

### GIZ-Office Tirana

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people's living conditions on a sustainable basis.

**GIZ . Office Tirana seeks the following staff: Advisor - Management of German Development Cooperation procedures**

#### A. Responsibilities

The Advisor is responsible for:

- supporting processes related to German Development Cooperation procedures on: governmental agreements, exchange of notes, implementation agreement, VAT reimbursement and financial reporting;
- maintaining of a good flow of communication and information between all involved institutions, the Ministry of Finance and Economy (MFE) and GDC;
- knowledge management

#### The FM performs the following tasks:

#### B. Tasks

##### 1. Advisory services on procedures

The Advisor,

- assists and monitors the above mentioned procedures between the respective line ministries, the MFE and GDC
- monitors and reports on the approval in the CoM and Parliament
- assists and monitors the implementation agreement process in accordance with the relevant GIZ regulations and Albanian laws, by collaborating closely with the respective programme managers and partner ministries;
- deals with the design, preparation and implementation of seminars and other events on procedures connected with: governmental agreement, exchange of notes, implementation agreement
- develops and organises quality assurance measures and suggests necessary changes, improvements and initiatives
- accompanies the programme managers or other members of GDC to meetings on above mentioned procedures if necessary and follows up on meeting results . but also holds administrative meetings independently with MFE partners

##### 2. VAT reimbursements and financial reporting

The Advisor,

- ensures that financial and legal information is exchanged between MFE/programme/ country office staff, partners and other institutions, especially on new respective changes of GIZ regulations and local laws, administrative requirements, VAT etc.
- manages and monitors VAT reimbursement and reports accordingly
- support submitting VAT requests for reimbursement and monitors it regularly
- advises MFE on relevant financial aspects of GIZ
- quality check of financial reporting

##### 3. Other duties/additional tasks

The Advisor,

- reports all problems with financial administration and compliance without delay
- performs other duties and tasks related to GDC procedures at the request of the Vice Minister Finance of MFE and the superior (GIZ country director)

#### C. Required qualifications, competences and experience

- university or master degree in law, public administration or similar area
- at least 5 years of professional experience within government institutions
- in-depth knowledge of the relevant local laws and public administration
- confidential handling of data and information
- good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office)
- very good knowledge of English, ideally a knowledge of German
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed . corresponding measures are agreed with management.

#### Contract conditions:

- Full-time employment
- Work place in Tirana within the MFE
- Assignment period strictly: 1 Year

Please forward your application until **18th of July 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de), including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

**Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.**

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**



Muzikë 'live' dhe argëtim në qytetin e serenatave, ndërthurja e shijes dhe traditës

**KORÇË**

Atmosfera që të fton drejt jetës së qejfit dhe argëtimit, festë, muzikë dhe birrë të mirë. Mbrëmjet kalohen bukur këtë verë në Korçë në restorantin shtëpia e Birrës Korça, tashmë i restauruar. Momente të nxehta feste në qytetin juglindor, ku qytetarë të shumtë argëtohen nën ritmet e muzikës live dhe shijes së freskët të birrës së parë shqiptare, birrës "Korça" në mjediset e bukura të restorantit Shtëpia e Birrës. Ç'mund të duash më shumë në këto ditë vere për të kaluar mbrëmje të këndshme? Shtëpia e Birrës Korça vjen pranë jush me ambientin e ri. Këtu do të shijoni birrën e freskët Birrën Korça, do të gjeni shërbim të kualifikuar, do të shijoni gatimet tradicionale të Korçës. Specialitet i këtij restoranti shoqërohet dhe me serenatat korçare, të mirëpritura në metropolin shqiptar. Metropoli i ballafaqon të gjitha vlerat, ku gjen të ndërthurura shijen, traditën dhe muzikën. Për të qenë sa më pranë gjërave të theksuara dhe miqësisë së natyrshme, është kujdesur për çdo detaj të këtij restoranti me gatime tradicionale korçare. E fillojmë nga atmosfera, që nis me tavolinat prej druri dhe servijerët e birrës "Korça" në të gjitha variacionet e saj; bionde, të zeza, në shishe etj. Në një pronë,

# Ditët e nxehta kalohen vetëm në "Shtëpinë e Birrës Korça"

*Flet administratorja Gjirici: Një nga investimet më të mëdha në Korçë*



"Shtëpia e Birrës" në Korçë



**RESTORANTI**

Momente të nxehta feste në qytetin juglindor, ku qytetarë të shumtë argëtohen nën ritmet e muzikës 'live' dhe shijes së freskët të birrës së parë shqiptare, birra "Korça" në mjediset e bukura të restorantit "Shtëpia e Birrës". Ç'mund të duash më shumë në këto ditë vere për të kaluar mbrëmje të këndshme?!

cim për "Gazeta Shqiptare" Arsenida Gjirici, administratore e restorantit "Shtëpia e Birrës", tregon se çfarë e bën të veçantë dhe kaq të dashur për korçarët këtë restorant. Zonja Gjirici shprehet se veç ambientit familjar, argëtim-it, ushqimeve tradicionale

dhe birrës Korça, ky restorant është njëkohësisht edhe një nga investimet më të mëdha që është bërë në këtë qytet. "I gjithë ambienti është restauruar, i përafrohohet një birrarie. Nga e marta në të diel në mbrëmje rreth orës 19:00

kemi muzikë live, serenata, këngë të ndryshme. Ndërkohë ofrojmë edhe gatime tradicionale. Ambienti është bërë i ri, është një ndër investimet më të mëdha të bëra në qytetin e Korçës, rrallë e gjen tek restorantet e tjera, ose më saktë nuk gjendet në asnjë

loj restoranti që është birrari", u shpreh Arsenida Gjirici, administratore e restorantit. Kujtojmë se është bërë tashmë traditë që çdo vit në sezonin e verës, "Birra Korça" organizon festën e birrës në qytetin e Korçës. Pjesëmarrja nga të

gjitha trevat në këtë festë e kthen qytetin në festival të vërtetë birre, ku kurorën e mban vetëm birra "Korça".

Këtë vit ashtu siç është bërë tashmë publike festa e birrës do të zhvillohet nga data 8-12 gusht në qytetin e Korçës.

**Shpërndanin doza heroine, bien në pranga tre persona**

**KORÇË**- Policia e Korçës ka goditur një grup të shpërndarjes së heroinës në doza të vogla, ndërsa në pranga kanë përfunduar 3 persona. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Korçë, në bashkëpunim me Specialistët e Seksionit për Narkotikët, bënë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të shtetasve Julian Gega (Mingo), 39 vjeç; Mikel Mingo, 24 vjeç dhe Mondi Mingo, 42 vjeç, të tre banues në Korçë. Arrestimi i tyre u bë pasi, gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Korçë, në dyqanin në pronësi të shtetasve Mondit dhe Mikelit Mingo, në lagjen nr.9 Korçë, të marrë në përdorim nga shtetasi Julian Gega, si edhe gjatë kontrollit fizik të këtij të fundit, iu gjetën e sekuestruan në cilësinë e provës materiale 13.2 gramë lëndë narkotike e dyshuar Heroinë, e ndarë në doza dhe 1 peshore. Gjithashtu, shtetasi Julian Gega, tek dyqani i cili shërbente si servis celularësh, tregtonte aparate satelitore pa dokumentacionin dhe autorizimin përkatës, si edhe rreth 300 aksesore të ndryshëm telefonash, për të cilat nuk dispononte fatura.

**SHKURT**

**Kreu një sërë vjedhjesh në Elbasan, arrestohet "skifteri" 34-vjeçar**

**ELBASAN**- Policia e Elbasanit ka arrestuar një 34 vjeçar, banues në lagjen "28 Nëntori" si dhe ka shpallur në kërkim shokun e tij E.V., pasi akuzohen për disa grabitje. Në kuadër të operacionit të koduar "Yamaha", në pranga ka përfunduar Frederik Maranaku. "Nga veprimet hetimore është arritur të dokumentohet me prova ligjore se shtetasi Frederik Maranaku në bashkëpunim me shtetasin E.V., në kohë dhe vende të ndryshme kanë kryer vjedhje të ndryshme në qytetin e Elbasanit si dyqane, motorë, biçikleta. Konkretisht më datë 05.07.2018 në Lagjen "28 Nëntori", në katin e parë të një pallati, dyshohet se i kanë vjedhur kanjellat material alumini shtetasit G. Sh.; më datë 05.07.2018, dyshohet se kanë vjedhur biçikletën e tipit "Scott", të shtetasit D.G, banues në lagjen "28 Nëntori", Elbasan; më datë 31.03.2018, në lagjen "Visarion Xhuvani", dyshohet se kanë vjedhur biçikletën, me vlerë 30.000 lekë pronë e shtetasit A.B.; më datë 04.02.2018 në lagjen "Dyli Haxhire", dyshohet se i kanë vjedhur motomjetin tip "Yamaha", shtetasit R.K.; më datë 17.02.2018, në lagjen "Brigada 17 Sulmuese", dyshohet se kanë vjedhur me thyerje dyqanin me artikuj ushqimor të shtetasit A.S, ku kanë marrë steka me cigare të llojeve ndryshme; më datë 26.02.2018, në lagjen "Haxhias", dyshohet se kanë vjedhur një motoçikletë tip "PJAXHO", pa targa në magazinën e shtetasit F.A..

**Abuzoi me tenderin për përroin, dënohet ish-krëbeshkiaku i Krujës**

Gjykata e Krujës dënon ish-krëbeshkiakun e Krujës Shkëlzen Hoxha. Gjatë gjykimit u provua se ai ka abuzuar me një tender për sistemin e një përroi në Krujë me vlerë 8 milionë lekë. Treshja gjyqesë me kryesues Ded Miri dhe Alfred Gjoni e Marçela Shehu, vendosi t'i pezullojë dënimin me burg, duke e lënë në shërbim prove për një periudhë 4-vjeçare. Gjykata urdhëroi që Shkëlzen Hoxhës t'i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë trevjeçare. Nga hetimi i prokurorisë së Krujës ka rezultuar se vlera në terren e investimit në këtë projekt është shumë më e vogël, duke arritur në konkluzionin se ish-kryetari i Bashkisë dhe administratori i kompanisë, që fitoi procedurën e prokurimit, kanë vjedhur mbi 8 milionë lekë të reja.



**Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.**

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

Paketat Super	Super 500	Super 700	Super 1100	Super 1300	Gigastike	Super 1900
Çmimi (me TVSH)	500 Lekë	700 Lekë	1,100 Lekë	1,300 Lekë	1,300 Lekë	1,900 Lekë
Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse)	300	200	2500	3000	400	3500
Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks	300	400	500	3000	400	3500
Minuta Ndërkombëtare				30		60
SMS drejt ALBtelecom Mobile	300	400	1000	2500		3000
SMS Kombëtare			500	400	400	300
SMS Ndërkombëtare						
Internet 3G/4G		300 MB	3 GB	5 GB	5 GB	12 GB
Internet 3G/4G+						3 GB
Përfitime të tjera					10 GB (Social & Chat)	
TV				ALBtv Mobile	ALBtv Mobile	ALBtv Mobile
Vlefshmëria	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare [www.albtelecom.al](http://www.albtelecom.al) ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123."

Qytetarët: Shteti të na pajisë me trasta, nuk kemi para t'i blejmë

# Ndalimi i qeseve plastike, ligji ende i pazbatueshëm

Voltiza Duro

P prej datës 4 korrik ka hyrë në fuqi ligji për ndalimin e prodhimit, tregimit dhe përdorimit të qeseve plastike të holla nën 30 mikron, por përvarësisht kësaj, subjektet dhe qytetarët vazhdojnë t'i përdorin. Ditën e djeshme, Shoqata e Konvertuesve të Plastikës të Shqipërisë APKA ka dhënë detaje mbi karakteristikat e caktuara teknike që duhet të kenë qeset që do të përdoren, në funksion të ruajtjes së mjedistit. Shoqata bën me dije se i mbështet përpjekjet e qeverisë për zbatimin e këtyre ndryshimeve në funksion të ruajtjes së mjedistit dhe nxitjes së ripërdorimit dhe riciklimit në vend. Kështu sipas shoqatës, trashësia për anë e qeseve plastike mbajtëse nuk duhet të jetë më e vogël se 35 mikron dhe duhet të ketë në përmbajtje aditiv biodegradues që të mundësojë vetëdegradimin e qesës në natyrë në jo më pak se 36 muaj. Gjithashtu, këto qese plastike duhet të kenë të stampuar në një pozicion të dukshëm sistemin e shenjimit për të realizuar gjurmueshmërinë e produktit dhe konkretisht : prodhuesin (Importuesin); Shenjën e riciklimit; Shenjën e ripërdorimit; Llojin e lëndës së parë të përdorur; Aditivin Biodegradues që përmban; Datën e prodhimit (datë, muaj, vit); Shenjën identifikuese që tregon se qesja është e riciklueshme dhe duhet depozituar e mblodhur e ndare nga mbetjet organike; si dhe shenjën për përdorim në kontakt drejtpërdrejt me produkte ushqimore nëse ajo është prodhuar për këtë qëllim. "Për këto ndryshime bëjnë përjashtim qeset plastike të përdorura për qëllime higjieno-sanitare (si qese e thasë për mbajtjen dhe transportimin e mbeturinave)", thekson shoqata.

## ZBATIMI I VENDIMIT

Para 4 ditësh Këshilli i Ministrave vendosi që të ndalojë përdorimin e qeseve të holla nën 30 mikron në Shqipëri. "Gazeta Shqiptare" ishte e pranishme ditën e djeshme në disa prej pikave të shitjes, treg apo market ku shumica e qytetarëve apo bizneseseve shprehen se nuk janë në dijeni për hyrjen në fuqi të këtij ligji. "Nuk kemi informacion që duhet të mos i përdorim qeset e holla. Ja akoma po i përdorim. Pronari nuk na ka thënë gjë



## SUBJEKTET

"Nuk kemi informacion që duhet të mos i përdorim qeset e holla. Ja, akoma po i përdorim. Pronari nuk na ka thënë gjë akoma, e derisa të na vijë urdhri nga ai, me këto do i shpërndajmë ushqimet", - tregon për 'GSH' një prej shitësve të një marketi pranë Gjakatës së Krimeve të Rënda.

## KARAKTERISTIKAT E QESEVE NË PËRDORIM:

- ▶ Trashësia për anë e qeseve plastike mbajtëse nuk duhet të jetë më e vogël se 35 mikron
- ▶ Duhet të ketë në përmbajtje aditiv biodegradues që të mundësojë vetëdegradimin e qesës në natyrë në jo më pak se 36 muaj
- ▶ Duhet të ketë të stampuar në një pozicion të dukshëm sistemin e shenjimit për të realizuar gjurmueshmërinë e produktit dhe konkretisht :
  - ▶ Prodhuesin (Importuesin)
  - ▶ Shenjën e riciklimit
  - ▶ Shenjën e ripërdorimit
  - ▶ Llojin e lëndës së parë të përdorur
  - ▶ Aditivin Biodegradues që përmban
  - ▶ Datën e prodhimit (datë, muaj, vit)
  - ▶ Shenjën identifikuese që tregon se qesja është e riciklueshme dhe duhet depozituar e mblodhur e ndare nga mbetjet organike
  - ▶ Shenjën për përdorim në kontakt drejtpërdrejt me produkte ushqimore nëse ajo është prodhuar për këtë qëllim
  - ▶ Për këto ndryshime bëjnë përjashtim qeset plastike të përdorura për qëllime higjieno-sanitare (si qese e thasë për mbajtjen dhe transportimin e mbeturinave)

akoma, e derisa të na vijë urdhri nga ai me këto do i shpërndajmë akoma ushqimet", - tregon për 'GSH' një prej shitësve të një marketi pranë Gjakatës së Krimeve të Rënda. Ndërkohë jo pak qytetarë mendojnë se para se të hynte në fuqi ky ligj, ata duhet të ishin pajisur

me trasta. "Pse të mos lejohej qeset, ku do i mbajmë ushqimet? Para se shteti të marrë këto vendime duhet që paraprakisht të na kishin pajisur me trasta. Unë jam pensionist, e nuk kam para të blej edhe trashën", - thotë për 'GSH' pensionisti me inicialet M.G.J.



**UNHCR**  
United Nations High Commissioner for Refugees  
Haut Commissariat des Nations Unies pour les réfugiés

## EXTERNAL VACANCY NOTICE

ALB/TIR/18/GS/01

Office of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) in Tirana, Albania is looking for qualified and highly motivated candidates interested to apply for the following position:

**Title of Position:** Snr. Programme Assistant, G5  
**Duty Station:** Tirana, Albania  
**Type of contract:** Temporary Assignment GS5 (General Service)  
**Duration:** 5 months  
**Application Deadline:** July 23<sup>rd</sup>, 2018, 17:30 CET

**1. ORGANIZATIONAL CONTEXT.** Define the role of the position within the team, describing its leadership role, if any, it's external/internal work relationships or contacts, the contextual environment in which it operates and the scope of supervision received, and where applicable, exercised by the incumbent.

The incumbent normally receives guidance from more senior programme staff in the operation. S/he may receive indirect guidance from other sections and units relevant to the country programme(s). UNHCR Manual, Operations Plans, UN and UNHCR financial/budgetary rules and regulations will guide the work of the Senior Programme Assistant.

The incumbent is expected to have contacts within the organization and outside the duty station, as well as with partners and other stakeholders to collect information, monitor programme activities and implement administrative requirements.

**2. FUNCTIONAL STATEMENT.** Describe the accountabilities, responsibilities and authorities associated with the position.

**Accountability** (key results that will be achieved)

- UNHCR country office has sufficient administrative assistance and support in routine services and activities within Programme Section thus better able to meet the needs of persons of concern.
- IP agreements are established in a timely manner, regularly monitored and reported on in compliance with established guidelines and procedures.

**Responsibility** (process and functions undertaken to achieve results)

- Collects, registers and maintains information on project activities.
- Prepare status and progress reports, prepare tables and draft routine correspondence.
- Prepare background material for use in discussions and briefing sessions.
- Undertake proper collection, monitoring and use of baselines, standards and indicators needed to measure and analyse programme performance, trends and target interventions.
- Review the implementation and performance of IPs agreements through appropriate physical monitoring to evaluate the projects by reviewing work plans, progress reports, budget, financial records and expenditures. This may include field visits for specific monitoring and evaluation issues.
- Apply UNHCR's corporate tools (e.g. Global Focus, Focus Client) to assess the technical soundness of the operation and generate data for evidence-based decisions at the country-level.
- Assist in ensuring compliance in issuance of audit certificates for Implementing Partners.
- Perform other duties as required.

**Authority** (decisions made in executing responsibilities and to achieve results)

- Provide inputs for the country operations plan (including budgets, staffing levels and structures) as well as prepare inputs for funding submissions, appeals and reports.
- Access the relevant information and programme records, Focus/MSRP data.
- Represent UNHCR in physical monitoring of projects.

**3. REQUIRED COMPETENCIES,** which illustrate behaviours that are essential to achieving deliverables described above, and that are critical to successful performance. All jobs require the staff to abide to the Values and Core competencies of UNHCR. Where applicable, select a maximum of six Managerial and list up to six functional competencies. Select a maximum of three Cross-Functional Competencies. (Note that the Performance Appraisal and Management System (PAMS) allows for up to five Cross-Functional Competencies to be selected by the staff member and the supervisor.

- Managing resources
- Analytical Thinking
- Planning and Organizing

**4. ESSENTIAL MINIMUM QUALIFICATIONS AND PROFESSIONAL EXPERIENCE REQUIRED.**

- Completion of Secondary education courses/ training/ certificate in Business Administration, Social Science, International Law or related field.
- Minimum 4 years of previous job experience relevant to the function.
- Computer skills (in MS office).
- Fluency in English and working knowledge of another relevant UN language or local language (as applicable in the duty station).

**5. DESIRABLE QUALIFICATIONS & COMPETENCIES.** Describe any experience or knowledge that would be an asset, such as: UNHCR Learning Programmes, other training, additional languages, Field/HQs experience, etc.

- Good knowledge of financial rules, procedures and processes.
- Knowledge of specific program management including budgeting
- Prior exposure to UNHCR refugee operations and functions relating to office administration and programme activities.

## IMPORTANT NOTE:

- Interested candidates should read the Terms of Reference carefully and apply if suitably qualified.
- Candidates are required to submit signed Motivation Letter and UNHCR P11 form.
- UNHCR P11 form and Supplement form are available: [www.unhcr.org/recruit/p11new.doc](http://www.unhcr.org/recruit/p11new.doc) (open Hyperlink). Please note that any previous versions of the P11 will no longer be considered.
- Applications of father, mother, son, daughter, or siblings of a staff member of UNHCR cannot be considered.
- Applications will not be acknowledged. Only shortlisted candidates will be contacted and invited for the written test and the interview;
- Applicants with working experience in International Organizations, preferably United Nations, are highly encouraged to apply;
- For any query please contact: [albt@unhcr.org](mailto:albt@unhcr.org)

**Interested candidates** should submit their applications (Completed UNHCR Personal History (P.11) form, P11 Supplement form and Motivation Letter) electronically by e-mail to: [albt@unhcr.org](mailto:albt@unhcr.org) or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Str., Gurten Building, 2<sup>nd</sup> floor, Tirana, Albania referring to the Vacancy Notice reference UNHCR: ALB/TIR/18/GS/01.

Deadline for submitting applications is **23<sup>rd</sup> July 2018, 17:30 CET**. Late or incomplete applications received without the above specified documents will not be considered;

## FARMACISTËT E RINJ PRAKTIKA

Rregullorja/ Kategoritë e kandidatëve që përjashtohen plotësisht apo pjesërisht nga detyrimi

# Zbardhen datat e regjistrimit për praktikën profesionale të farmacistëve të rinj

*UFSH: Ja sa duhet të paguani për 3 muaj*

Voltiza Duro

P prej datës 10 korrik, të gjithë farmacistët e rinj, do të kenë mundësinë të bëjnë regjistrimin për kryerjen e praktikës profesionale. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë zbardh datat e regjistrimit të praktikës për të gjithë të interesuarit si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët. "Regjistrimet për kryerjen e praktikës profesionale për sezonin korrik-tetor 2018 do kryhen gjatë periudhës 10 - 16 korrik 2018. Praktika profesionale kryhet në farmacitë e rrjetit të hapur ose spitalore, nën drejtimin e një farmacisti me jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune", thekson UFSH. Më tej kjo e fundit bën me dije se praktikantët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Urdhrit dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Përkatësisht farmacistët duhet të paraqesin: kërkesën; vetëdeklarimin; një kontratë tip për kryerjen e praktikës profesionale; një fotokopje të certifikatës së anëtarësimit në UFSH të drejtuesit të praktikës; si dhe një fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.



### TARIFA

Ndërkohë të gjithë ata që do të kryejnë praktikën profesionale 3-mujore për profesionin e rregulluar të farmacistit, duhet të dorëzojnë edhe mandat pagesën në shumën prej 100 mijë lekësh të vjetra në numrin e llogarisë së përcaktuar nga UFSH.

Gjithashtu, praktikantët duhet të dorëzojnë edhe një fotokopje të kartës së identitetit; raportin mjeko-ligjor; fotokopjen e plan-vendosjes së farmacistit si dhe 3 fotografi në përmasat 3x3.5 cm. Ndërkohë të gjithë ata që do të kryejnë praktikën profesionale 3 mujore për profesionin e rregulluar të farmacistit, duhet të dorëzojnë edhe mandat pagesën në shumën prej 100 mijë lekësh të vjetra në numrin e llogarisë së përcaktuar nga UFSH.

### KËRKESA

Në kërkesë praktikantët

duhet të deklarojnë se pasi u njohën me rregulloren e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, dëshirojnë të kryejnë regjistrimin për kryerjen e praktikës profesionale. "Unë i/e nënshkruari/a, pasi u njoha me Kodin Deontologjik, Statutin dhe Rregulloret e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Betimin e Hipokratit sipas formulimit të Gjenevës të vitit 1948, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Shërbimin Farmaceutik në Republikën e Sh-

### DOKUMENTACIONI

Praktikantët për t'u regjistruar për kryerjen e praktikës profesionale duhet të paraqesin në Zyrën e UFSH dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë
2. Vetëdeklarim
3. Kontratë tip për kryerjen e praktikës profesionale
4. Fotokopje e certifikatës anëtarësimit në UFSH të drejtuesit të praktikës
5. Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave;
6. Fotokopje e kartës së identitetit;
7. Raport mjeko-ligjor
8. Fotokopje e plan-vendosjes së farmacistit;
9. Tre (3) fotografi (3x3.5 cm);
10. Mandat pagesën në shumën 10000 lekë, në numrin e llogarisë 69623 pranë bankës BKT. Dokumentacioni i kërkuar gjendet në faqen zyrtare <http://www.ufsh.org.al/membership/praktika-profesionale>

stitucioneve të akredituara që kanë të drejtë të pranojnë praktikantët. Praktikanti ka të drejtë të zgjedhë nga lista e shpallur institucionin dhe profesionistin udhëheqës së praktikës", theksohet në rregulloret. Ndërkaq, do të përjashtohen plotësisht apo pjesërisht nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, të gjithë ata kandidatë që provojnë se për një periudhë të caktuar kohore, kanë arritur të ushtrtojnë profesionin apo të kryejnë praktikën profesionale jashtë vendit. "Për të vlerësuar dhe për t'u bindur nëse përvoja e kandidatit është e mjaftueshme për ta përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, UP mbështetet në një dokument zyrtar të lëshuar nga institucioni ku ka ushtruar veprimtarinë profesionale apo një dokument zyrtar lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit përkatës për rastet kur është kryer një periudhë praktike profesionale jashtë vendit", theksohet më tej në rregulloren e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë

qipërisë, kërkoj të regjistrohem për kryerjen e praktikës profesionale pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, duke u zotuar për zbatimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky regjistrim", duhet të deklarojë në kërkesë.

### ZHVILLIMI I PRAKTIKËS

Praktika profesionale do të kryhet në ato institucione shëndetësore që

plotësojnë standardet për realizimin e kërkesave dhe përvetësimin e njohurive praktike-teknike dhe etike të praktikantit. "Kjo praktikë zhvillohet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar që ka ushtruar profesionin në mënyrë të ligjshme dhe të pavarur për një periudhë 3 vjet. Ministria e Shëndetësisë përcakton dhe miraton listën e in-



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE

### ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2018

Banka e Shqipërisë fton të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në konkursin e hapur "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018", i dedikuar për studentët shqiptarë të diplomuar gjatë periudhës 1 tetor 2017 - 30 shtator 2018, brenda dhe jashtë vendit, për punë shkencore në një nga çështjet e ekonomisë monetare e ndërkombëtare, stabilitetit financiar, çështje të integritetit ekonomik të vendeve të Ballkanit në Evropë, politika monetare dhe politikë makroprandiale të Bankës së Shqipërisë, politika fiskale dhe roli i tyre në ekonomi, sistemi bankar shqiptar, sjelljet e individëve dhe firmave në Shqipëri, si dhe aspekte të ekonomisë në përgjithësi.

Studentët e interesuar duhet të paraqesin në formë elektronike (pdf) në adresën elektronike [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org), dokumentet e mëposhtme:

- një letër ku shprehet interesim i studentit për të konkurruar për Çmimin në fjalë;
- *Curriculum Vitae*;
- abstraktin dhe një përmbledhje të shkurtër të gjetjeve kryesore;
- emrin e udhëheqësit të temës dhe universitetin/fakultetin përkatës;
- temën e diplomës.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve është data 31 tetor 2018.

Për më shumë informacion mbi rregullat e pranimit, lutemi vizitoni faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org) ose shkruani në adresën e emailit [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org).

*Mesazhi elektronik drejtuar Bankës së Shqipërisë në adresën [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org) duhet të referohet "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018".*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3.581.600 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 - 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 01 Gusht 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## INTERVISTA

# EUGEN KALLFANI: Për Beratin e UNESCO-s

Fatmira Nikolli

"Nëse Pjetri i madh i Rusisë e pa Europën nga një dritare e Petërburgut, ju shqiptarët e shihni atë nga një mbi një dritaret e qytetit të Beratit". *Terri Devis, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, shtator 2005.*

10 vite më parë, Berati do të bëhej pjesë e UNESCO-s në një sesion të mbajtur në Kebek të Kanadasë. 10 vite më pas, Eugen Kallfani, drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare flet për sfidat që ka para: nga shtëpitë në rrezik të kishat e mbyllura, nga plehurat që nuk mbarojnë të kabllot elektrike që përdridhen si gjarpërinj.

**Berati feston këto ditë 10-vjetorin e hyrjes në UNESCO. Me gjithë promovimin e bërë dhe rritjen e numrit të turistëve, në qytetin e vjetër ka ende shumë probleme, që lidhen kryesisht me shtëpitë karakteristike, një pjesë e të cilave rrezikojnë të shemben. Çfarë masash ka marrë DRKK e Berati dhe a po ndërhyhet me restaurime në këto vlera të trashëgimisë kulturore?**

DRKK Berat ka nën juridiksionin e vet 478 monumente kulturore që ndodhen në të gjithë qarkun mes të cilave 421 janë banesa, kategoria e I dhe e II. Për sa i përket restaurimit të banesave sipas ligjit në fuqi për banesat e kategorisë së parë DRKK financon 50% të investimit ndërsa për banesat e kategorisë së dytë 30% të financimit. Ne gjatë një viti ndërhyjmë në disa monumente, kjo edhe falë fondeve që kemi në dispozicion dhe fuqisë punëtore sipas strukturës aktuale. Jemi të predispozuar të ndërhyjmë në ato monumente që e kanë më emergjent restaurimin duke i shpëtuat nga degradimi i mëtejshëm. Sigurisht që kaq nuk mjafton, por trashëgimisë kulturore po i jepet një rëndësi e veçantë gjatë këtyre viteve ndaj ne jemi optimistë që shumë më shumë do të bëhet në vazhdim. Tashmë Berati ka disa vjet që është kthyer në një qendër historike ku po punohet me një strategji shumë të qartë e cila ka në themel bashkëpunimin shtet-privat. Dera e zyrës së ateliesë qëndron e hapur për çdo qytetar dhe mund të them se që nga 2014 e deri tani janë kryer punime restauruese dhe mirëmbajtjeje në mbi 40 monumente. Ndër më kryesoret, Ura e Goricës, Ura e Velabishtit, Ura e Kasabashit në ndërhyrje pjesore, Kisha e Shën Vangelizmoit, Kisha e Shën Triadhës, Afresku i kupolës së kishës së Sh. Triadhës, e dhjetëra banesa. Restaurimet kanë vijuar dhe me veprat e artit, në ikona e në afreske. Kemi hartuar mbi 12 projekte këto 3 vitet e fundit dhe kemi bërë të mundur të ekspozojmë ikonat në bashkëpunim me muzeun ikonografik "Onufri" duke ngritur pavionin "Thesaret e fjetura". Po punohet aktualisht për restaurimin e Xhamisë "Mbret", xhamisë së "Beqarëve", Teqesë "Helveti" me financim të TIKA por me një bashkëpunim shumë të ngushtë me Institutin e Monumenteve, ku kemi kontribuar në

## Problematikat, risqet e sfidat 10 vjet pas shpalljes pasuri botërore



Eugen Kallfani, drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare

ndjekjen e punimeve, hartimin e projekteve dhe mbarëvajtjen e një procesi rrënjësor restaurimi, i cili do të mbyllet brenda vitit 2019.

**Përpos restaurimeve që ju përmendni, këto banesa kanë edhe probleme me furnizimin me ujë 24 orë, çka do të hiqte përfundimisht rezervuarët e ujit mbi shtëpitë e vjetra. Mbi këto shtëpi sytë të shohin po aq edhe kabllot elektrike, që estetikiisht nuk qëndrojnë në ansamblin. A ka ndonjë projekt për zgjidhjen e kësaj problematike?**

Është shumë e vërtetë që prezenca e kablove elektrike ndikon negativisht qoftë nga ana vizuale por edhe nga rreziku që ato mbartin për rënien e zjarrit. Me Bankën Botërore po kërkohet të ndërhyhet me një projekt fillimisht në lagjen Goricë e më pas në lagjet e tjera në mënyrë që e gjithë linja ajrore të kalojë nën tokë, të kemi ndriçim muzeal profesional, rikonstrukcion për rrjetin e ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe më pas restaurimin e gjithë kalldrëmeve në Goricë.

Për sa i përket ujit të pijshëm është po ashtu një problem por që duhet të marrë zgjidhje nga pushteti lokal, pra, bashkia duhet ta ketë prioritet këtë pjesë pasi eliminimi i rezervuarëve të ujit është një zgjidhje që duhet të jepet në një afat kohor afatmesëm dhe

po jo afatshkurtër. Kërkohen investime shumë të mëdha që në burim, rrjeti në Mangalem është i gjithi i ri në fakt sepse u rindërtua por furnizimi me ujë 24 orë është një çështje që i takon pushtetit lokal. Ajo që mund të them është që nuk mund të pretendojmë turizëm elitare nëse nuk kemi furnizim me ujë 24 orë, nëse nuk eliminim kabllot elektrike, nëse nuk kemi lagje të pastra apo nëse nuk i japim lehtësira bizneseve për parkimin.

**Pastërtia. Si në shumë qytete e destinacione turistike të vendit, edhe në Berat mbeturinat shpeshherë i gjen ngado. Sa ndikon kjo panoramë tek turistët? Dhe a mund të ndërhyjë DRKK, apo është problem që i takon vetëm Bashkisë?**



Është një problematikë me të cilën ne përballemi çdo ditë në qytet. Pastrimi i ambienteve nga mbetjet nuk është në detyrat e DRKK-së, megjithatë ne përipiemi vazhdimisht me aq mundësi sa kemi për të mbajtur një ambient të pastër. Së fundmi, kemi të përcaktuar nga Ministria e Kulturës edhe një punonjës sezonal për Kalanë, i cili merret me mirëmbajtjen e ambienteve dhe pastrimin nga vegjetacioni.

Kemi kërkuar shpesh herë edhe zyrtarisht bashkëpunim nga Bashkia Berat që të ndërhyjë më shpesh për pastrimin e ambienteve në Kala dhe në dy lagjet e tjera muzeale, sidomos gjatë sezonit. Një ambient i papastër nuk është aspak mikpritës e mbi të gjitha nuk i lë shije të mirë asgjë, ndaj zgjidhja është që Bashkia të për-

është muzeale është nën administrimin tonë dhe ata s'kanë përgjegjësi apo e kundërta. Turizmi kërkon koordinim, bashkëpunim ndaj ne kemi nevojë që të lidhim marrëdhënie reciproke. Kohët e fundit në prefekturë është ngritur një komision i posaçëm i cili mbledhet periodikisht për probleme të tilla dhe duhet thënë se gjuha e bashkëpunimit është gjendur dhe disa problematika kanë gjetur zgjidhje.

**Me gjithë këto probleme që sapo përmendët, UNESCO duket se e ka bërë në këto 10 vite punën me promovimin e qytetit. A është shtuar ndjeshëm numri i turistëve sipas të dhënave që kemi dhe të cilës kombësi janë vizitorët më së shumti?**

Vizitorët në Berat kanë njohur një rritje të konsiderueshme krahasuar jo vetëm me disa vite më parë por edhe me vitin e shkuar. Për periudhën Janar-Qershor, pra për 6 muajorin e parë të vitit 2018, sipas statistikave zyrtare kanë ardhur 56.600 vizitorë në Kalanë e Beratit, nga të cilët 20.140 kanë qenë vizitorë të huaj dhe pjesa tjetër vendas dhe nxënës. Nëse bëjmë një krahasim me të njëjtin periudhë të vitit të shkuar rezultojnë 22.833 vizitorë më shumë, një shifër kjo që tregon se Berati vit pas viti po kthehet në një destinacion turistik kulturor shumë të preferuar. Turistët huaj vijnë më shumë nga vende, si: Polonia, Franca, Turqia, Gjermania, Italia, Greqia, etj.

**Dhe çfarë i josh më tepër këta turistë të huaj në Berat, ç'zonë vizitojnë më tepër?**

Një nga gjërat që turistëve u bën më shumë përshtypje është historia e qytetit, Kalaja, banesat dhe arkitektura e spikaturit e tyre, pa lënë pas mikpritjen dhe kullinarinë. Turistët e huaj vlerësojnë shumë edhe bashkëjetesën fetare, sepse për hir të së vërtetës, rrallë ndodh që të shohësh në një qytet kaq të vogël kishat dhe xhamitë të cilat qëndrojnë kaq pranë njëra-tjetrës...

**Megjithatë, gjatë vitit, disa kisha që ndodhen në Kala janë të mbyllura për turistët. A është menduar për hapjen e tyre, të paktën gjatë sezonit të verës?**

Në vijim të komunikimit të Ministrisë së Kulturës me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë lidhur me mundësinë e koordinimit të vizitueshmërisë në monumente të kulturës (kisha), të cilat janë në administrim të këtij komuniteti, në kuadër të sezonit turistik veror dhe lehtësirat e vizitorëve ne kemi publikuar edhe në faqet tona zyrtare orarë në të cilat Kishat janë të hapura gjatë ditës si edhe numrat e kontaktit të personave kujdestarë. Disa nga Kishat që do të qëndrojnë të hapura gjatë sezonit janë: Kisha e Shën Spiridonit, Shën Thomait, Shën Mëhilli, Shën Mëri Villaherna, Shën Kollit, etj.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 617

SUPLEMENTI I PERJAVSHEM  
E shtunë 7 Korrik 2018

GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

**MODERATORI  
ALBI ISAKAJ:**



**JA ÇFARË SURPRIZË  
JU REZERVON SHTATORI!**



**ERA ISTREFI**

**MARTOHET APO NË NJË LIDHJE ME  
PRODUCENTIN E KËNGËS SË BOTËRORIT?**

# BLEONA QERETI RIKTHEHET ME ISH-BASHKËSHORTIN? JA SI QËNDRON E VËRTETA

*Postoi foto në 'Instagram',  
këngëtarja ngre dyshimet se  
bashkohet me Gani Bardhën*



**DIELL, DET DHE  
RELAKS! JA VIP-at  
QË JANË MARROSUR  
PAS MAGJISË  
SË BLUSË**



# BLEONA QERETI rikthehet me ish-bashkëshortin? Ja si qëndron e vërteta


*Postoi foto në 'Instagram', këngëtarja ngre dyshimet se bashkohet me Gani Bardhën*

vijon të jetë single, madje në kërkim të mashkullit perfekt. Edhe pse është një nga femrat më joshëse të skenës shqiptare, e duhet thënë një vajzë mjaft e guximshme që pëlqen të provokojë, Bleona Qereti po ende nuk e ka gjetur djalin e ëndrrave. Bleona e fshehu për disa kohë divorcin, derisa më në fund e publikoi duke thënë se ajo dhe ish-burri Ganiu kanë mbetur miq të mirë. "Jam ndarë nga Gani, ai do jetë gjithmonë familja ime", është shprehur atëherë këngëtarja. Edhe pse jo të martuar ligjrisht, marrëdhënia e tyre dashurore është mbyllur me konsensus. "Gani do të ketë gjithmonë një vend të veçantë në zemrën time, por rrugët tona tashmë janë ndarë. Është shumë e vështirë të mbash të gjallë një lidhje në distancë, megjithatë ai do të jetë gjithmonë familja ime", -ka thënë Bleona. Duket që nuk e ka pasur shumë të lehtë marrjen e këtij vendimi. Megjithatë, vetëm dy vjet pas ndarjes, Gani Bardhi u fejuua me një amerikane 40-vjeçare, me të cilën vazhdon të jetë edhe sot. Bardha i është përkushtuar pasionit të tij për makinat, ndërsa thuhet se prej kohësh ka nisur bashkëjetesën, ndërsa është në prag të martesës me partneren e re. Ajo është pavarësisht të gjithave një nga ikonat e bukurisë dhe guximit të këngëtarëve në Shqipëri. Bleona është vajza e çmendur, që jeton pa kokëçarje, ata që e njohin e dinë mirë që ajo dhe Gani kanë pasur një lidhje të jetuar bukur. Duke iu rikthyer sërisht karrierës së saj në SHBA, ajo vihet re shpesh që ajo është pjesë e organizimeve të ngjarjeve më të rëndësishme në Hollywood duke na përfaqësuar gjithnjë, siç Bleona di të shfaqet. Ndërsa së fundmi ajo ka paralizuar se do të lançojë një tjetër produksion ku në faqen e saj në 'Instagram' ka lajmëruar ndjekësit e saj. "Në një farë mënyre ndjej se i meritoj faljet... që kur unë di për të, por ajo nuk di për mua...'. Kjo është videoja e parë e debutimit. Më thoni ç'mendonni lidhur me aftësitë e mijra lidhur me kontrollin", shkruan Bleona në postimin e fundit në 'Instagram'. Me siguri do të jetë një diçka ndryshe dhe e guximshme ndryshe nga tipi i këngëtares, ndërsa të gjithë e dimë se asaj i pëlqen të guxojë. Gjithë kjo energji në jetë, por kur do të vijë princi i kaltër për Bleonën? Ende nuk e dimë!

Pamela Aliaj

**P**as një heshtjeje të gjatë që nga ndarja nga me ish-bashkëshortin, nisën sërisht thashethemet lidhur me këngëtares e njohur shqiptare, Bleona Qereti. Edhe pse tashmë kanë kaluar 4 vite që nga ndarja me biznesmenin nga Kosova, Gani Bardha, së fundmi u përhapën sërisht zërat për një ribashkim të tyre. Kjo ka qenë për shkak të postimit të një fotoje në 'Instastory'-n e saj ku shkruante edhe emrin e ish-bashkëshortit. Por sipas burimeve për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" këngëtarja ka një marrëdhënie vetëm shoqërore me Gani Bardhën. Pra, kjo nuk do të thotë se një postim i rastësishëm në faqen e saj në 'Instagram' tregon se çifti është rikthyer sërisht bashkë. Ndërkohë që këngëtarja vijon jetën e saj drejt rrugës së suksessit në SHBA, atje ku ndodhet edhe Bardha, ndërkohë që ky i fundit vijon të bashkëjetojë me 44-vjeçaren amerikane tashmë prej 4 vitesh. Gjithashtu, rikujtojmë



se këngëtarja ka qenë ajo që ka pranuar për herë të parë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" se është ndarë nga bashkëshorti dhe se do të mbeteshin gjithnjë shokë. Ndërsa tani mund të themi se pavarësisht aludimeve, Bleona



## BLENDI FEVZIU

### shijon pushimet në Mykonos

Ai njihet tashmë për pasionin e tij të madh lidhur me udhëtimet dhe shumë shpesh e shohim që "fluturon" nëpër vende të ndryshme të botës. Kësaj radhe, pas përfundimit të 'Opinion', mendonim se ai do të zgjidhte një destinacion më të largët sesa Greqia. Por mesa duket, ishulli ekzotik i Mykonos, në Greqi, i ka tërhequr mjaftueshëm vëmendjen për ta zgjedhur atë si destinacionin e parë për këtë verë për të kaluar pushimet. Kushedi se ku do ta gjejmë më vonë Blendin. Ky është vetëm fillimi!



### "Më kishte marrë malli", AMI TOSKA rikthehet në Greqi

Pas pushimeve me familjen në Turqi, Ami ka preferuar të vijojë sërish pushimet larg të nxehtit të kësaj vere duke zgjedhur edhe ajo të shijojë Greqinë. "Sa më kishte marrë malli", shkruan Ami në një nga fotot e postuara në 'Instastory'. Me siguri që edhe nga pamjet e fotografuara, bukuroshja është duke kaluar momente të veçanta nën shoqërinë e familjes së saj.



# Diell, det dhe relaks! Ja Vip-at që janë marrosur pas magjisë së blusë

Pamela Aliaj

Tashmë pas një muaji plot me shira, më në fund u rritën temperaturat në Shqipëri. Vetëm se destinacionet këtë vit nuk kanë qenë vetëm brenda kufijve të vendit për të shijuar pushimet. Vip-at tanë kanë mundësi të udhëtojnë nëpër vende të ndryshme të botës, duke lënë kështu për në fund bregdetin e Jonit dhe Adria-

tikut. Çdo javë do të shohim se ku do të jenë destinacionet e tyre për të shijuar detin e diellin. Kësaj here nën lupën tonë kanë qenë disa nga Vip-at shqiptarë, të cilët preferuan vendet fqinje si Greqia apo Italia për të vijuar sezonin e relaksit për këtë verë të nxehtë.

## Superseksi dhe në formë, ZAIMINA VASJARI poston foto me bikini

Nuk kanë kaluar veçse pak muaj ndërsa ne e shohim që ajo shfaqet në superformë! E kush tjetër veçse bukuroshja Zaimina Vasjari, e cila është shfaqur si një sirenë e vërtetë në bordin e anijes në të cilën është nisur me pushime. Por si është e mundur që në kaq pak kohë ajo të ketë një bark kaq të sheshtë dhe me forma të një modeleje? Të gjitha e kanë zili trupin e saj superseksi. Lum Zai për vullnetin dhe fatin që ka!



## ANJEZA MAJA

### I vë 'flakën' rrjetit social, moderatorja shfaqet superseksi

Padyshim që kjo ka qenë një kohë surprizash për një nga moderatorët shqiptarë. Ne e shohim çdo mëngjes në emisionin 'Në shtëpinë tonë', në Top Chanel, por asnjëherë se kemi parë kaq seksi veshur me bikini. Në një foto të postuar së fundmi, ajo duket mjaft tunduese, dhe kjo është një gjë që rrallë herë ndodh ta shohim tek Anjeza Maja. Pasi u shfaq pjesë e klipit të Klajdi Harunit dhe Brunos, Anjeza befason me këtë foto nga Jala në jug të vendit. Ajo ka kthyer të pasmet dhe ka lënë të gjithë pa fjalë me trupin e saj.



Flet moderatori: Ju tregoj eksperiencën më të keqe që kam kaluar



I RIKTHEHET EKRANIT NË KLAN?

# ALBI ISAKAJ:

## Ja çfarë surprize ju rezervon shtatori!

*“Nudo do jem vetëm për gruan në shtëpi”*

Pamela Aliaj



**Si fillim nisim nga planet që ju presin në shtator. Ku do ta shohim Albin së shpejti?**

Albin mund ta shihni në 'Instagram', në rrugë, në kafe, në autobus, kudo. (qesh)

**Para pak kohësh njoftuat se do të nisnit të punonit në Klan tv. Për çfarë bëhet fjalë?**

Në fakt, u shpreha se kisha marrë një propozim për të punuar në Klan. Nëse do të jem apo jo në sezonin e ri, mbetet surprizë.

**Çfarë zhanri programi do të donit të moderonit në me-**



*Padyshim që keni vënë re të gjithë se si ai spikati si një nga moderatorët më simpatikë dhe karizmatikë të In TV. Por përveçse nën rolin e moderatorit, ai e ka provuar veten në disa fusha, në modeling, si edhe në kërcim. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare” Albi Isakaj ka folur më tepër lidhur me rikthimin e tij në ekran. Albi tregoi se shtatori do të jetë me surpriza dhe se ka marrë një ofertë për të qenë pjesë e Tv Klan, por jo vetëm kaq! A do të jetën nën moderimin e një emisioni muzikor apo...? Gjithashtu, ai na rrëfeu edhe disa të pathëna lidhur me jetën e tij private. Do të guxonit të pozonit nudo? ...do të pozoja nudo vetëm për...Për më tepër lexoni intervistën e mëposhtme.*







Çdo ditë zbulojmë nga një surprizë nga këngëtarja e njohur Era Istrefi. Përveç faktit që i është përkushtuar muzikës në maksimum dhe po punon për projekte të reja, kohët e fundit nuk dimë asgjë për jetën sentimentale të këngëtares. Ajo është përfolur më parë për lidhjen e më pas ndarjen nga ish-menaxheri i saj, Faton Shoshi. Por në një fotografi që Era e ka postuar "Instagram", asaj i ka komentuar producenti i këngës së Botërorit, Thomas Wesley Pentz, i njohur me emrin artistik Diplo. "I love you" (Të dua), i ka shkruar Diplo Erës në fotografi, ndërsa ajo s'ka hezitur që t'ia kthejë komentit, duke i shkruar "Ily too" (Edhe unë të dua). Mbetet të shihet nëse në mes tyre ka një lidhje dashurie, apo këto janë thjesht komente në mes kolegësh. Ndërkaq, së fundmi ajo papritur zbuloi se është martuar dhe na çudit të gjithëve, me një unazë në gisht ajo ka treguar se është martuar me veten e saj. "Zyrtarisht e martuar me veten time", - shkruan këngëtarja mbi videon e postuar. Madje, në një tjetër postim ajo ka treguar edhe festimet e martesës me veten në një drekë të zakonshme. Mesa duket, Era ka hequr dorë nga lidhjet dashurore për momentin dhe i vetmi person me të cilin do të angazhohet është vetja e saj. Këngëtarja kosovare me famë botërore, Era Istrefi, së fundmi ka qenë në qendër të vëmendjes me pjesëmarrjen e saj në këngën e cila është realizuar për Kampionatin Botëror të Futbollit. Kjo ishte një mënyrë për të larguar vëmendjen nga thashethemet lidhur me Diplo apo jo? Mbetet për t'u parë...

## Martohet Era Istrefi, apo është në një lidhje me producentin e këngës së Botërorit? Tregon në rrjetet sociale unazën e shtrenjtë



Kurrë më.

**Nëse nuk do të ishte moderator, me çfarë do të merrej kryesisht Albi?**

Marketing, është një ndër fushat që më pëlqejnë më shumë në një të ardhme jo shumë të largët.

**Ju kanë lidhur me Xhensila Peren, Ana Liken dhe me një blonde me flokë të shkurtra nëpër mediat rozë, cila është 'Ajo' që i ka rrëmbyer zemrën Albit?**

Xhensilën e kam shumë xhan, Annën tashmë e konsideroj familje, ndërsa kjo e treta nuk po më kujtohet. (qesh)

**Çfarë nuk do të toleroni në një lidhje?**

Indiferencën. Jeni lindur e rritur në Peshkopi, cili është zakoni që keni marrë nga ai vend dhe s'e ndryshoni dot?

Bujaria, jam më tepër bujar se ç'duhet.

Nga çfarë s'do mund të hiqte dorë Albi asnjëherë?

Familja, për asnjë arsye. A keni patur ndonjë ofertë për modeling nga ndonjë kompani e njohur? Ku do të donit të ishit imazh dhe a do të guxonit nudo?

Në Shqipëri kam qenë dikur imazh i një kompanie të njohur, por jashtë vendit akoma. Nudo vetëm për gruan në shtëpi. (qesh)

dia?

Më pëlqejnë shumë programet muzikore, megjithatë çdo zhanër ka bukurinë e vet.

**Cili është pasioni i fshehtë i Albit?**


Akrimi, shumë shpejt do me shihni në Hollywood (qesh)

**Sa vend zë "Ajo" në jetën tuaj?**

"Ajo"?! Kur ta gjej.

**Cila është eksperiencia që keni provuar dhe jeni penduar?**

Të heq mjekrën (qesh).



# Rriten temperaturat, Françeska zhvishet në ballkon

**N**uk kanë se si të mungojnë postimet e herëpashershme të modeles seksi, Françeska Jaçe. Ajo ka zgjedhur këtë herë jugun e vendit për disa ditë pushimi. Fraçi ka dalë në ballkonin e hotelit ku qëndron krejtësisht nudo teksa mbulohet vetëm me çarçaf. Françeska është një nga ish-banoret e "Big Brother" më të përfolura dhe më provokuese. Kaq ka mjaftuar dhe në publikimin e saj kanë vërsuar komente nga më të ndryshmet prej fansave. Pa përmendur ata që kanë pasur mundësinë ta shohin 'live' Françin që zhvishet në ballkon. Një bombë e vërtetë!



## “Zihen” bukuroshet e Noizyt? Ja çfarë i thonë në koment njëra-tjetrës

**A**to u bënë menjëherë pjesë e grupit OTR, pas largimit të bujshëm të Encës. Po flasim pikërisht për dy femra që u përfolën edhe më shumë nëpër mediat 'online', pasi hynë në këtë grup të famshëm. Oriola Marashi dhe vajza e këngëtarit Sabian, Keisi

Medini, janë pothuajse të pandara dhe shihen kudo me reperin Noizy, madje janë shfaqur edhe në klipet e tij më të fundit. Edhe pse rrallëherë shfaqen së bashku, ato duket se kanë një raport mjaft të mirë me njëra-tjetrën, kjo edhe sepse janë pjesë e të njëjtit grup. Ndërkohë që së fundmi ka spikatur një koment i bërë nga Oriola për Keisin. Mike apo rivale?



## Klaudi Pepa rikujton Albin? I habit të gjithë me mesazhin e saj

**H**istoria e dashurisë mes Albi Nakos dhe balerinës Klaudia Pepa prej fillimeve të saj ka qenë në qendër të mediave, por edhe pas ndarjes së tyre, vijojnë të jenë të dy nën fokus. Përveç jetës private, Klaudia dhe Albi janë duartrokitur pambarim nga ndjekësit e tyre dhe kjo tregohet më së miri në postimin e balerinës. Klaudia ka ndarë një foto në "Instastory"-n e saj nga koha kur punonte me trupën e baletit të Albit dhe ka një duartrokitje për të gjithë ata që falë punës së tyre mundën të kenë 10 milionë 'views' në këtë koreografi. Në postimin e saj, Klaudia ka etiketuar Albin dhe Albën, të cilët janë përfolur së fundmi për një fejesë të mundshme, që u mohua prej të dyve. Pra, kjo tregon qartë se nuk ka asnjë hatërmбетje mes të dyve, si dy shokë që duartrokasin dhe mbështetin njëri-tjetrin.





## “Dua të kem fëmijë”, modelja shqiptare habit me kërkesën e saj

Ajo është në kulmin e karrierës së saj profesionale, mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Europës. Modelja e njohur Xhesika Berberi papritur na ka lënë të gjithëve pa fjalë. Mes angazhimeve të shumta në sesione fotografike dhe pasarella, bukurshja shqiptare me sa duket i ka të qarta idetë edhe në planin privat. Zyrtarisht, ne ende nuk e dimë nëse ajo është në një lidhje dashurie, por dimë diçka të sigurt: ajo do një fëmijë! Këtë nuk e themi ne, por e pohon vetë Xhesika përmes një fotoje që ka postuar në “Instagram” bashkë me një bebë të bukur që mban në krahë, ndërsa shkruan në të: “E dua një!” Edhe pse vetëm 27 vjeçe, asaj i vjen natyrshëm dëshira për t’u bërë nënë.

## Femrat çmenden pas Ledrit, Ledri çmendet pas...

Ai është padyshim një prej këngëtarëve shqiptarë më të pëlqyer të momentit. Ledri Vula ka një numër të madh fansash dhe të gjithë çmenden pas tij, por edhe këngëtarët kanë këngëtarë të tjerë të preferuar, pa përmendur femrat. Por së fundmi, Ledri na ka treguar me anë të një postimi në “Instastory” se ka qenë në Zvicër duke ndjekur një koncert të këngëtarit Pharrell dhe të bandës së hip hop-it, Migos. Në videot e postuara nga Ledri shohim një atmosferë të ndezur dhe shumë njerëz që ndjekin koncertin. Po ashtu, këngëtari ka postuar një foto me French Montana-n dhe me reperin amerikan që njihet me emrin e artistit si Joey Badass. Edhe Ledri ka të preferuarit e tij në botën e muzikës.



## Martohet balerini i njohur, ja fotografia e parë e Kledi Kadiut dhe partneres së tij pas dasmës

Një tjetër dasmë e qershorit, e cila kaloi pa bërë shumë bujë ishte ajo e balerinit shqiptar Kledi Kadiu dhe partneres së tij franceze, Charlotte Lazzari. Ishte vetë Kledi, i cili preferoi që të gjithë ceremoninë martesore ta mbante sa më të fshehtë, madje edhe miqtë e tij më të ngushtë u kujdesën që të publikonin sa më pak detaje nga dasma. Megjithatë, revista italiane “Gente” ka publikuar fotografinë e parë të Kledit dhe bashkëshortes së tij si të martuar. Kledi dhe Charlotte duken shumë të lumtur pranë njëri tjetrit në foton e parë si bashkëshortë. Ndërkaq, kujtojmë se balerini shqiptar dhe partnerja e tij kanë 18 vite diferencë së bashku dhe janë prindër të një vajze 2-vjeçare, Lea. Ndërsa në fotografinë e siguruar nga “Vox Albanie” duket se në dasmën e tyre nuk kanë munguar edhe miqtë shqiptarë si Ilir Shaqiri, Lorik Cana, Anbeta Toromani, Igli Tare, Dorian Grori dhe Klodian Çela.



Opinion i Ditës

# Përse u këmbëngul me “përsheptim” shembja e Teatrit Kombëtar?

Nga Kiço Blushi

(vijon nga faqja 1)

... e arkitektit të teatrit tonë modern, Pirro Mani, e plot të sing-jashmëve të tyre që dëshpërimisht po vazhdojnë të kundërshtojnë, peticionojnë, artikulojnë e protestojnë që qeveria, kryeministri, Kuvendi, aktorët, intelektualët, deputetët, analistët, gazetarët e gjithë tjetër çka përbën atë që quhet opinionin publik, t'i vënë gishtin kokës, të mbyllin debatet sh-terpë e të nisnin rikonstrukcionin jo vetëm të ndërtesës së Teatrit, por të kompleksit “Skënderbeg”, kësaj qendre muzeale unike, jo vetëm të kryeqytetit, por të historisë së Shqipërisë në njëqindvjeçarin e fundit.

Një qeveri e një kryeministër do duhej të gjykonin më së paku elektoralisht. Një udhëheqës që e do kombin e vet, që mban përgjegjësi para historisë, mjaft të ketë sadopak respekt për emrin e vet (me kusht që të mos i jetë vdirur prej vetëngopjes nga mbipushteti, droja instiktive për të mos lënë gjurmë shkatërrimi në histori...), do të ishte tërhequr me nder. Edhe neosulltani Erdogan u tërhoq para ca vitesh për prishjen e sheshit “Tikrit” në Stamboll.

Çështja në do të priset ose jo Teatri prej muajsh ka kapërcyer e anashkaluar të gjitha hallet e Shqipërisë, politike e sociale, përfshi edhe hapjen ose jo të negociatave. Madje edhe ethet e kampionatit botëror të futbollit. “Tepsia” dhe “timoni” dhënë një njeriu të vetëm provoi, duke u ballafaquar me “Teatrin”, se ç’ukubera mund të bëjë një mazhorancë e trajtuar si kope.

\*\*\*

E megjithatë, mos i bini më qafë Edi Ramës. As mëkëmbësit të tij Veliaj. Aq më pak ministres së Kulturës, që vetëm emrin e ka të formësuar (sigurisht jo për meritë e dashurisë së “të lindur” për artin e kulturën) me nota muzikore... Sepse prishjen ose jo të Teatrit nuk e ka më në dorë qeveria, as zotëruetit fuqiplotë të timonit e të tepsisë, pasi ajo hapësisë historike tash asht “tokë e xamun”. Jo nga të pastrehët, që zaptojnë ndonjë bunker për të futur kokën, por nga oligarkët. Tash edhe më trushkururit e propagandës qeveritare duhet ta kenë kuptuar se janë këta që komandojnë, jo më një parti e kryetar partie, por edhe votat e parlamentit. Edhe votat tona.

Nuk është vetëm hapësira e Teatrit “tokë e xamun” nga “Fusha-t”, por e gjithë Shqipëria.

Rama nuk mund të tërhiqej se kontratat qindramilionëshe kanë pas qenë firmosur, sigurisht bashkë me penaltitetet. Projektet për kullat madhështore ishin ideuar e kërkuar nga vetë Rama, skicuar nga studioja e arkitektit me famë



botërore”, i cili denjoi të vinte vetë në Tiranë për të na shpjeguar që ndërtesa e Teatrit duhet shembur, se... se ka edhe rrezik zjarri dhe kanceri... Kjo do të thotë se studioja në fjalë e arkitektit të shquar është paguar nga firma për kullat dhe Teatrin e ri të PPP-së. Ndaj nëse Rama, pas protestave për armët kimike u detyrua të tërhiqej e të kundërshtojë madje edhe marrëveshjen me amerikanët, me “Fushën” këtë nuk e bën dot. E ka të pamundur. Vendimmarjen mbas sodit e kanë në dorë “Fusha-t”, jo qeveria, as kryeministri fuqiplotë, aq më pak opinionin publik dhe komuniteti i aktorëve.

Rama nuk tërhiqej dot, si nuk e bëri me koncesionin e Rrugës së Kombit. Me demok, tërheqja që u detyrua të bënte qeveria “Rama” prej protestës së dhunshme të kuck-sianëve nuk ishte ndjesë, as pranim gabimi, por kompensim fi-

nanciar për koncesionarin, duke mbuluar shteti, pra taksat tona, “dëmet”. Ndaj, çmimin e kalimit të rrugës e shoqëroi jo vetëm me kompensimin e uljes së biletës, por edhe me shlyerjen e dëmeve për firmën “Kastrati”... Pse? Sepse kontratat ishin firmosur në fshehtësi, pa tender, bashkë me penaltitetet.

Sepse edhe Rruga e Kombit paskësh qenë “tokë e xamun”. Dhe sepse vetëm tek ne ndodh që koncesionet të mos jepen me përfitim për shtetin e për publikun, por humbet e tyre (cila kompani merr një koncesion me humbje?) u financokan nga shteti, si ka ndodhur me Rinasin, çekap-in, naftën etj. Vetëm me këto para (mbi 70 milionë euro...) të hedhura në badjava e në qyl mund të ndërtoheshin në Tiranë jo një, po disa teatro!

Prandaj Lubonja e ka gabim kur

thotë se protesta duhet bërë si e kuksianëve... Jo për faj të disa aktorëve që janë akuzuar si të shitblerë (se edhe ata kanë halle, fëmijë, shtëpi...), as pse dihet që edhe ata që rezistojnë nuk do të shtrihen para buldozerëve e nuk do të rrëmbenë gurë e shkopinj për t'i hedhur kundër rruspave, por se të gjitha palët e përfshira në këtë zallamahi e kanë pësuar-mësuar në këto vite se, duke nisur që nga vota e deri të protesta, argumenti, interesi publik, madje edhe ai që quhet opinion publik nuk kanë as takat dhe as mundësi të ndikojnë, të përmirësojnë apo të ndryshojnë, jo më qeverisjen, por as realitetin vetë, sepse janë të tredhur. Tepsia dhe timoni tashmë nuk janë në duart e atyre që votuan, por të “Fusha”-ve.

Këtë provoi odiseja e Teatrit. Tek ne, në vitin 2018 fuqia e opinionit publik nuk shkon më larg se shprehja “Bjerini legënit”.

\*\*\*

Andaj në përrurimin e Artturbinës, me singeritetin që e karakterizon, Rama pohoi: “Nuk kanë punë me Teatrin aktorët, regjisorët, intelektualët, të gjithë ata që udhëheqësi i përmbledh në një fjalë duke i futur në kazanin mediatic, sepse “në Shqipërinë që duam” vendos ai, ai që ka edhe tepsinë, edhe timonin, në bashkëpunim me ndërtesuesit, dmth me

oligarkët. Prandaj Teatri do të shembet. Prandaj kryeministri nuk kishte asnjë mundësi tërheqjeje. Prandaj shembeni një sahat e më parë! Sa më shpejt, aq më mirë! Që të mbyllet kjo sherrnajë absurde, fundi i së cilës dihet: ERTV dhe makina e propagandës së Veliajt duhet të nisnin një tjetër fushatë me sukseset e “Shqipërisë që duam”, me stilin bjeritëbiem, mburru vetë e mos prit të të mburrin të tjerët, hidh batuta dhe tallje publike për ata që janë mësuar të hanë bar, makar edhe për ata që kundërshtojnë... Në Shqipëri nuk ka më opinion publik, shoqëri civile, marrëdhënie institucionale pozitive-opozite, madje nuk ka as mazhorancë funksionale e normale, në kuptimin klasik të kësaj fjale... Tek ne kryeministri para Ramës i bëri thirrje Berluskonit të sillte investitorë të huaj se ka vajza të bukura, kurse pasuesi i tij, Rama, iu mburr Rencit se nuk kemi sindikata që të bezdisin si në Itali. Nuk bën keq t'i mburret Merkelit se tek ne, mbas sodit, nuk ka as opinion publik.

Sepse, tekefundit, kërret tanë legendarë, të cilëve u vete pas historia jonë mamece që nuk kundërshton edhe kur e përdhunojnë, këtë e dinë fort mirë: çudia, vakia, habia, zemërimi, imati... në këto vise të mbjella me harresë kolektive, nuk zgjasin më shumë se tri ditë. Sepse për Rilindjen, më i rëndësishëm qenkësh bunkeri (të cilin “BBC” e quajti ‘bunkeri nuklear i Koresë së Veriut në Evropë’...) që ngallon krenarisht pak më tuje, se kompleksi muzeal “Skënderbeg”, ku nuk qenkëshin luajtur vetëm pjesë teatrore, simfoni, po edhe drama kombëtare, si gjyqet politike pas lufte... Por as këto nuk kanë pikë rëndësie mbas sodit.

Sepse tashmë u provua që në Shqipërinë tonë të tepsisë dhe të timonit nuk kanë asnjë vlerë e asnjë ndikim protestat, votat, debatet, interesi publik, trashëgimia historike e kulturore... Nuk kanë më peshë jo vetëm ligjet, por as Kushtetuta. “Bjerini ju legënit!”, “Le të lehin qentë e kazanit!”, se karvany në rilindar e ka gjetur tashmë “Fushën” e tepsisë, ku mund të hedhë vallen e trimave të majekrahit demokratik...!

Më kot i bini më qafë Ramës dhe i kërkonti të tërhiqej. Nuk e ka ai në dorë të tërhiqej. Pasi që sot e tēju, që të bësh hair e prokopi, duhet të jesh fushë. Sigurisht jo tokë buke, po mundësisht truall... Të jesh një lepeqe, dmth fushë nga mendja, nga dinjteti. Dhe sidomos nga përkushtimi e përlësia pa kushte që vazhdojnë të kemi ndaj udhëheqësve tanë karizmatikë, të cilët historikisht, tradicionalisht e papërshtatimisht e kanë përcaktuar vetë çmimin e kiles së pordhës së tyre në tregun mediatic e publik!

Opinion *i* Ditës

# Superleku dhe Banka e Shqipërisë

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... euro, etj.), për shkak të mbarëvajtjes së ekonomisë që përfaqëson. Përkundrazi. Tek e fundit, vlera e shtuar që prodhohet në një ekonomi e forcon monedhën. Mirëpo kur arsyet nuk janë ato themelore (rendimenti i rritur, eksportet, investimet e huaja, etj.), rritja e vlerës së këmbimit të monedhës vendëse bëhet artificiale dhe e dëmton ekonominë në tërësi. Këtë rritje kallpe po e pëson edhe leku ynë prej tri vitesh tashmë, por si domos prej 7 muajve të fundit (në raport me euron, për periudhën dhjetor 2017-qershor 2018 është rritur me 9 për qind). Prurja e pazakontë nga aktiviteti i shitjes së kanabisit, apo edhe tranzitimi i kokainës, e ktheu monedhën tonë krejt artificialisht në një supermonedhë. Rritja artificiale e monedhës vendëse i shqetëson shumë eksportuesit që humbasin drejtpërsëdrejti, por edhe bankat qendrore.

Nuk janë të rralla rastet kur bankat qendrore, edhe ato të vendeve të vogla blejnë valutë me shumicë, për të ndihmuar monedhën e tyre kombëtare të zhvlerësohet, të largohet nga një rritje që bën në shumë dëm, se sa favorizon. Në plan të parë, duket sikur lëvizin në treg për të mbrojtur eksportuesit dhe pritshmëritë (shpresat) e këtyre të fundit, madje edhe të qytetarëve që thjesht kanë valuta ndër duar, janë të larta. E ka bërë banka qendrore e Zvicrës për gati tri vite (shtator 2011-janar 2015). Kjo, për arsye se kriza ekonomike botërore që shpërtheu në shtator 2008 dhe arriti kulmin në vitin 2011 tronditi nga themelet besimin e investuesve ndërkombëtarë tek vlera e këmbimit e dollarit dhe euros, dhe të gjithë vrapuan tek frangun zviceran, si një liman i qetë ku mund të ankronin investimet e tyre. Banka Kombëtare e Zvicrës luftoi 1227 ditë për të zhvlerësuar frangun zviceran. Në nëntor të vitit 2013, nisi blerjet masive për të ulur vlerën e këmbimit të korunës edhe Banka Kombëtare e Çekisë. Tani, po e bën banka qendrore e Serbisë, e cila ka blerë 90 milionë euro në 35 ditë (29 maj-3 korrik 2018), për të zhvlerësuar sa të mundet dinarin serb tejet të fortë.

Të gjitha bankat qendrore që kërkojnë një monedhë kombëtare me vlerë më të ulët, i frikësohen uljes së inflacionit nga rritja e vlerës së monedhës përtej kufijve kontrollues, deri në rrezik për deflacion. Deflacioni është dukuria kur për një periudhë kohe (qoftë edhe dy tremujorë njëri pas tjetrit apo një vit), mesatarja e çmimeve në një vend bie. Në pamje të parë, kur ulen në tërësi çmimet, duket si gjë e mirë, pse fiton konsumatori që blen pak më shumë. Në plan të së gjithë ekonomisë, kjo është situata më e rrezikshme, pse shpëton shtysat, impulset për sipërmarrësit që të prodhojnë më shumë mallra dhe shërbime. Ja përse



bankat qendrore e vendosin edhe në ligjin e tyre themeltar që shënjestrojnë (synojnë) mbajtjen e një inflacioni çmimesh në nivele të ulëta të kontrollueshme (Banka e Shqipërisë e ka 2-4 për qind inflacion në vit). Secili guvernator, si ai i Zvicrës në shtator 2011, i Çekisë në nëntor 2013, apo i Serbisë në maj 2018, deklaruan se blenë euro për të luftuar deflacionin.

Dhe mirë bënë. Banka e Shqipërisë bleu euro më 6 qershor

2018, kohë kur si sipërmarrësve, edhe qytetarëve po u "digjnin" euron që kishin ndër duar. Ndërhyrja ishte gati shpëtimtare. Në kohën dhe masën e duhur. Tregu reagoi menjëherë, duke zhvlerësuar lekun. U qetësuan qytetarët, eksportuesit, si dhe sipërmarrësit në tërësi. U qetësuan të gjithë. Guvernatori i bankës sonë qendrore doli në publik dhe garantoj se banka e të gjithëve (kështu realisht duhet konsideruar një bankë qendrore) do të ndërhynte, pra blinte euro, sa

herë rrezikoheshin objektivat e saj. Të gjithë morën frymë lirshëm. Por mina nën ujë është oferta dhe sasia e eurove të ekonomisë kriminale, asaj të drogës dhe korrupsionit.

Duke mos u ditur kjo sasi, nuk përgatit dot as edhe strategjitë mbrojtëse. Banka e Shqipërisë "çadrën mbrojtëse" duke blerë euro pa pushim, sa herë bie kursi i euros në Shqipëri, nuk mund ta mbajë hapur përgjithmonë. Janë të domosdoshme studime krahasuese për praninë e eurove nga aktiviteti kriminal dhe stokun e tyre në ekonominë tonë, me të dhëna alternative dhe simulime që mund të përcaktojnë deri diku me vërtetësi sasinë e eurove që e bëjnë lekun superlek. Për këtë ia vlen të ndërregjeshohet si banka jonë qendrore, ashtu dhe INSTAT dhe institucionet e tjera që prodhojnë shifra. Është sikur të jesh në një ring dhe kundërshtarin të mos e shohësh, as edhe të mos e kuptosh fuqinë e grushtit që të vjen. Ke rrezik të biesh lehtë në "knock-down (përdhe)".

Nuk janë të rralla rastet kur bankat qendrore, edhe ato të vendeve të vogla blejnë valutë me shumicë, për të ndihmuar monedhën e tyre kombëtare të zhvlerësohet, të largohet nga një rritje që bën në shumë dëm, se sa favorizon. Në plan të parë, duket sikur lëvizin në treg për të mbrojtur eksportuesit dhe pritshmëritë (shpresat) e këtyre të fundit, madje edhe të qytetarëve që thjesht kanë valuta ndër duar, janë të larta.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të dish të zgjedhësh për më të mirën nuk është e lehtë, kur bëhet fjalë të mendoni si për mirëqenien tuaj ashtu edhe për atë të të tjerëve. Njerëzit i besojnë instinktit tuaj dhe kjo ju pëlqen. Por shtrrohet pyetja: po ju a i zini besë?

### DEMI

Kalimi i Hënës në qiellin tuaj do t'ju favorizojë lëvizjet, qofshin këto si për kënaqësi ashtu edhe për punë. Negociatat dhe puna do të ecin vaj. Priteni pozitivisht risinë. Edhe pse gjërat nuk ju duken shumë interesante, shumë shpejt ato do të jenë!

### BINJAKET

Jeni shumë i aftë për të çuar përpara negociatat rraskapitëse. Por në fund edhe ju mund të ndiheni të shtypur nën ngarkesën e tepërt të përgjegjësisë. Duhet të mësoni të ndani dhe të delegoni punët; ju nuk mund të mbani gjithmonë gjithçka mbi supë.

### GAFORJA

Me Hënën që ndodhet në pozicion të mirë, mendimet tuaja do të jenë më pak të turbullta dhe mund të ndriçoni të gjitha zonat e errëta që ju trembin. Në fund të fundit, kjo është edhe për të mirën tuaj. Nëse partneri ju kërkoi pak kohë, jini në dispozicion menjëherë.

### LUANI

Pasiguri të vogla për të shprehur emocionet tuaja të brendshme mund ta bëjnë të vështirë që partneri i jetës t'ju kuptojë. Dukeni i përhumbur, edhe pse në të vërtetë jeni duke pleqëruar thellësisht mbi një çështje që ju shqetëson.

### VIRGJERESHA

Nëse është e vërtetë se mjafton të duash për ta bërë diçka, është, gjithashtu, e drejtë të thuash se të vazhdoni në drejtimin e gabuar, ju bën të humbni shumë nga koha juaj e vyer. Mund të keni nevojë për një ndihmesë. Por nuk duhet ta pranoni, nëse do të kishit një përgjigje të tipit "a të thashë!"

### PESHORJA

Para se të futni dorën në kuletë, bëni disa llogaritë, për të kuptuar se cili shpenzim i tepërt, që nuk ishte i llogaritur mund ta mëtrni në konsideratë. Nëse mendoni se mund t'ia dilni pa pasur një gjë të caktuar për të pasur diçka tjerë, vetëm ju e keni në dorë për të zgjedhur.

### AKREPI

Shumë kërkesa që nuk presin rrezikojnë t'ju vënë për poshtë. Keni dëshirë t'ua përbushni dëshirat të tjerëve, por nuk mund të jeni i pranishëm me të gjithë! Gjëni ekuilibrin duhur, duke u udhëhequr nga instinkti dhe nga bionësi i thjeshtë.

### SHIGJETARI

Do të prisni me frikë ardhjen e një mesazhi të rëndësishëm, që po ju mban nën tension. Hiqeni këtë mendim, nëse nuk doni që të zmadhoni ankthin. Ndosta adresa ishte gabim ose dërguesi e ka harruar farenë. Por ju nuk i duroni dot pakujdesitë.

### BRICJAPI

Më shumë se për punën dhe afatet që mbarojnë, po mendoni sesi të argëtoheni me ndonjë rreng të bukur që t'i kurdisni mikut tuaj më të mirë! Në fillim puna, pastaj kënaqësia, ndryshe do të hani një të ulëritur ju shumë të këndshme.

### UJORI

Më të paqta a më pak agresiv, edhe pse duhet të qortoni dikë që nuk është shumë i vëmendshëm. Vëreni veten gjithmonë në pozicionin e tjetrit, përpara se ta kritikoni. Në çastin më të posaçëm do të dini gjithmonë t'i rimërrni në dorë frerët e situatës.

### PESHQIT

Të ngadalësuar nga pozicionimi hënor, ju mungon shpejtësia për të tejkaluar kundërshtarin tuaj si edhe për të fituar kështu një avantazh të konsiderueshëm ndaj tij! Do të jetë një përballje e fuqishme, por ajo që është e sigurt është se nuk do ta shisni kursesi lirë lekuren tuaj.

Anglia mungon në një gjysmëfinale që prej vitit 1990 dhe nuk e ka fituar Kupën e Botës që prej vitit 1996, por pavarësisht kësaj, atmosfera në ekip është ajo e duhura dhe "Tre luanët" janë gati të dhurojnë befasinë. "Edhe pse skuadra do të jetë më e mirë pas dy vitesh pasi do të ketë më shumë eksperiencë, ne nuk do ta kemi sërish këtë mundësi. Ndonëse nuk është mirë ta them tani, më duhet të pranoj se jam krenar për atë



Suedi-Angli, "Samara Arena", ora 16:00

Suthejt kërkon të shkruajë historinë

që po bëjmë. Është një privilegj i madh, erdhëm në këtë veprimtari si një ekip pa eksperiencë, një nga më të rinjtë, fituam duelin e parë me penallti pas 10 vjetësh, i pari në një Kupë Bote dhe kemi numrin më të lartë të golave në një ndeshje. Nuk luajmë në gjysmëfinale që prej vitit 1990. Jemi ambiciozë dhe

duam të fitojmë". Edhe sulmuesi Herri Kejn, golas-hënuesi më i mirë i kampionatit, beson shumë të fitojë. "Lojtarët i shoh si vëllezërit e mi dhe ata më shohin ashtu. Jemi të uritur për fitore. Kur të duhet të luash një betejë si kjo, merr energji dhe besim se mund t'ia dalësh. Duam më shumë

se kaq. E dashurojmë këtë ndjesi, nëse shkon në shtësi dhe penallti do të jemi gati. Do të jemi gati sido që të shkojë". Suedia bën një lojë shumë të qartë dhe bazohet të mbrojtja e fortë. Jane Anderson, trajneri i Suedisë deklaroi se asnjëherë nuk ka pasur dyshime sesi duhet të luajë ekipi i tij. "E kemi

kuptuar shumë herët, unë dhe asistenti im. Na u deshën rreth dy vite për të përcaktuar stilin tonë të lojës dhe çfarë na duhej për të qenë të suksesshëm. Duke qenë se të dy kemi qenë trajnerë klubesh dhe kemi luajtur një futboll krejt tjetër, duhej të ndryshonim diçka që të ishim gati për sfidat e reja. Ndjaj Anglisë nuk do të ketë shumë surpriza. Jemi të bindur për këtë. Jemi besimplotë se mund t'ia dalim".

Autogoli i Fernandinjos dhe De Bryjn kalojnë në avantazh Belgjikën

"Djajtë e kuq" ndezin ferrin për Brazilin

Në gjysmëfinale i pret Franca

Jeton Selimi

Belgjika dhuron befasinë e madhe. Skuadra e drejtuar nga Roberto Martinez ka nxjerrë jashtë veprimtarisë pretendentin numër një për trofeun e madh, Brazilin. Në fakt, Brazili ishte skuadra e fundit e mbetur nga treshja fillestare, ku bënte pjesë edhe Gjermania me Spanjën, por në çerekfinale është detyruar të hapë krahun. Kjo për shkak të një Belgjike që ka dhuruar një pjesë të parë të jashtëzakonshme. Ndonëse kërcënimin e parë e bën Brazili me Tiago Silvë, belgët arrijnë përsosmërisht të godasin me kundërsulmet e tyre. Edhe pse goli i parë vjen pas një devijimi të pafat të Fernandinjos, kur devijon në rrjetë gjuajtjen me kokë të Kompanit dhe shënon autogolin e 11-të në këtë Kupë Bote. Belgjika fluturon me Hazard h De Bryjn, aksione të shpejta nga krahët, kundërsulme vdekjeprurëse që vënë në panik prapavijën e Brazilit, e cila nuk arrin të përballojë furinë e "Djajve të kuq". Në minutën e 31-të do të vijë dyfishimi. Një diagonale perfekte nga De Bryjn që thyen Alson, kurorëzimi ideal i një aksioni model. Brazili kërkon të zgjohet, por pa forcë, ndërsa Belgjika mund të kishte shënuar edhe më në pjesën parë, por gjithsesi u mjaftua me kaq. 2-0 dhe ekipet shkojnë në pushim. Pjesa e dytë do të flasë më shumë për Brazilin, që kërkon në të gjitha mënyrat të rikthehet në lojë. Si në minutën e 56-të kur Gabriel Zhezus kërkon penallti, ndërsa Belgjika ka në këmbët e saj goditjen fatale në kundërsulm, por Hazard gjuan jashtë. Brazili do të shkurttojë diferencën në të 76-ën me një gol shumë të bukur me kokë Augusto, që thyen Kurtuan. Ngushtimi i avantazhit bën që Belgjika të mblidhet në prapavijë, ndërsa Brazili provon të shënojë duke aktivizuar të gjithë artilerinë e rëndë, por pa ia arritur. Sërish pretendim për penallti nga "Selecao" në të 91-ën me të zakonshmin Neymar, por edhe njëherë Mazic lejon avantazhin.



Vërshtëllima e trefishtë e kryesorit serb legjitimon fitoren e Belgjikës dhe bën që Brazili të shkojë në shtëpi me kokën ulur.

**FRANCA**  
Franca është gjysmëfinalistja e parë. Herën e fundit që "Gjelat" shkuan në gjysmëfinale, 20 vjet më parë,

fituan edhe Kupën e Botës në veprimtarinë që organizohej në shtëpinë e tyre. Sot ndaj Uruguait "Gjelat" triumfuan 2-0, por natyrisht që vuajtjen jo pak për të thyer bunkerin e ndërtuar nga Tabarez, e mbi të gjitha, po të mos ishte për dhuratën e Muslerës, mund të kishim parë një

tjetër ndeshje. Uruguai e nis ndeshjen lart, luan fort dhe bën presing. Franca përpiqet të kundërpërgjigjet, por Mbape është mbërthyer mirë në morskën e Kaseresit me shokë. Uruguai kërcënon në minutën e 36-të me Veginon, por ky nuk i jep forcë topit që prehet te duart e Loris.

**HUMBJA**  
Brazili ishte skuadra e fundit e mbetur nga treshja fillestare, ku bënte pjesë edhe Gjermania me Spanjën, por në çerekfinale është detyruar të hapë krahun. Kjo për shkak të një Belgjike që ka dhuruar një pjesë të parë të jashtëzakonshme.

Katër minuta më pas vjen ndryshimi në tabelën e rezultatit. Bentakur pengon Tolizon dhe Grizman harkon në zonë duke gjetur Varanen, që i vjedh kohën Stuanit dhe mposht Muslerën. 1-0 dhe Franca gëzon, ndërsa Uruguai kërkon të reagojë shpejt. Madje mund të kishin

barazuar në çastet e fundit të pjesës së parë, por Loris bën një superpritje në gjuajtjen me kokë të Kaseresit, duke e dërguar Francën e tij në pushim me një gol avantazh. Pjesa e dytë nis më e qetë me Francën që lejon Uruguain të afrohet, por pa i dhënë hapësira. Madje, "Gjelat" godasin sërish dhe e bëjnë duke përfutur nga gafa e Muslerës, një gol i pësuar alla-Karius, një top që rrëshqet nga duart dhe përfundon në rrjetë. Një gabim që kushton praktikisht eliminimin. Rezultati 2-0 sjell nervozizëm te uruguaijanët, që nuk i kursejnë ndërhyrjet e rënda, ndërsa edhe Franca duket se e ka hequr dëshirën për të vrapuar, ndonëse i afrohet golit. Momentet e fundit të ndeshjes janë dramatike për uruguaijanët, Gimenez në fushë shpërthen në lot ende pa u mbyllur koha e rregullt, ndërsa tifozët lënë pas zhgënjimin dhe brohorasin idhujt e tyre. Por Franca ishte më e fortë. Mbese me Kavanin mund të ishte një histori ndryshe, por në fund të fundit "Gjelat" kualifikimin, sepse në këtë 90-minutësh u treguan ekipi më i mirë.

Rusi-Kroaci, "Fisht Stadium", ora 20:00

Çerçesov-Daliç, sfida nis nga pankinat

Rusi-Kroaci do të nxjer Rrë edhe gjysmëfinalistin e fundit të kësaj kupe bote, ndërsa dilemat për këtë sfidë janë të mëdha. Mbese jo aq shumë për faktin që Rusia eliminoi Spanjën sesa për Kroacinë që hasi vështirësi ndaj Danimarkës. Trajneri i Rusisë, Stanislav Çerçesov, kërkon të kthejë me këmbë në tokë lojtarët e tij. "Ne jemi të përqendruar te puna jonë. Ndeshja kundër Spanjës ishte një histori shumë e bukur për kombin tonë, por tani duhet ta harrojmë atë. Nuk na

nevojitet euforia tani, sepse kampionati ende po luhet. Shumë skuadra të mëdha janë eliminuar dhe në një ndeshje me eliminim nuk ka vend për gabime". Mario Figueira Fernandez është një brazilian i natyralizuar rus dhe luan në krahun e djathtë të mbrojtjes. Natyrisht që vëmendja e mediave ndaj tij kishte lidhje me origjinën e lojtarit. "Njoh shumë prej lojtarëve të Brazilit, por nuk flasim me njëri-tjetrin gjatë veprimtarisë. Natyrisht që i shoh ndeshjet e tjera. Nuk shoh vetëm Brazilin, por të gjitha skuadrat e tjera. Duhet të


jemi të informuar". Zlatko Daliç kërkon kujdes nga të tjtë dhe i druhet Rusisë, mbi të gjitha sepse një tur më parë ka larguar nga gara një kampion të botës. "Kjo është një tjetër ndeshje dhe një mundësi e madhe për të dyja ekipet. Nëse mund Spanjën, atëherë meriton një vend mes 8 më të mirave të një Botërori. Nuk do të jetë e lehtë për ne të luajmë me publikun kundër, por lojtarët e mi janë mësuar me këtë, sepse luajmë çdo javë në ligat më të mira të botës". Ivan Rakitiç është padyshim një nga lojtarët më të rëndësishëm në mesfushën e Kroa-



cisë. Asi i Barcelonës mendon se Kroacia tashmë është gati të përballtet me ekipin pritës. "Katër vite më parë u ndeshëm me Brazilin, që or-

ganizonte Kupën e Botës. E shijua ndeshjen dhe atmosferën, ndaj kjo do të na ndihmojë që të mposhtim Rusinë përballë publikut të saj".

**Fjalëkryqi (1)**



- 34. Janë nofka.
- 38. Satelit i Jupiterit.
- 39. Fillojnë matjet.
- 41. Në krye tëv idealisatëve.
- 42. Një Ibrahim violinist.
- 44. Ekstre me sirtar.
- 45. Kështu shtë lojtari i under 21.
- 47. Eshhtë gjuajja personale.
- 49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
- 50. Gëlonin nga gladiatorët.

- HORIZONTAL**
- 1. Ishite dekret i sulltanit.
  - 8. Fillojnë nazet.
  - 9. Eshhtë bosht.
  - 10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
  - 13. Fillojnë romanin.
  - 14. Pak nepozitëm.
  - 17. Mbahen për të ndaluar.
  - 18. Janë njerëz me dy faqe.
  - 21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
  - 22. Nofka e Eisenhoëer.
  - 24. Janë ministri.
  - 25. Pak normalitet.
  - 26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
  - 27. Kush është... nuk është i lirë.
  - 29. Bën be pa u betuar një e tillë.
  - 30. Kështu mbyllet dera.
  - 33. Eshhtë për medaljen e parë


- VERTIKAL**
- 1. Eli këngëtare.
  - 2. Pak ekologjike.
  - 3. Rastis në kufij.
  - 4. Janë temperaturat më të ulëta.
  - 5. Inicialet e Lendi.
  - 6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
  - 7. Campion regjisor.
  - 8. Gabim rrjete në tenis.
  - 11. Janë si cilësi.
  - 12. Ishite gjuha e romakëve.
  - 15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
  - 16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
  - 17. I vihet kalit.
  - 18. Rrapo i luftëtarëve.
  - 19. Aktet pa kufij.
  - 20. Mbyllet me dorezë.
  - 21. Eshhtë periudha e ftohtë.
  - 23. Në krye të komandës.
  - 24. Një artist si Tristan Tzara.
  - 28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
  - 31. Hapin pa kufij.
  - 32. Oethen me qen.
  - 35. Një mendim.
  - 36. Kusturica, regjisor.
  - 37. Parajsa e humbur.
  - 39. Një stacion i famshëm orbital.
  - 40. Pak aromatike.
  - 43. Pak interesante.
  - 46. Lirë në qendër.
  - 48. Nota e diapazonit.

**Fjalëkryqi (2)**


- HORIZONTAL**
- 1. Bunuel regjisor.
  - 4. Të parat në sport.
  - 6. Rodrigues që këndonte fado.
  - 11. I famshmi Pacino.
  - 12. Kujdeset në... ekstreme.
  - 14. Eshhtë skllavëri.
  - 16. Eshhtë shtypi jo përditshëm.
  - 18. Janë tek në banka.
  - 20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
  - 21. Lumi i Bernës.
  - 23. Janë me numër ato ushtarake.
  - 24. Nesti pa pa çifte.
  - 25. Si gjithë.
  - 26. Sipërfaqe e shkurtër.
  - 27. Ato të peshkut janë pa vlerë
  - 28. Janë marifete... me grim.
  - 31. Ethet e tij zunë kërkuesit.

- 32. Skuadra merengue.
- 33. Eshhtë trofet që fitohet.
- 34. Ndahen nga ortakët.
- 36. Një biçikletë dyshe.
- 39. Qetësonte detin.
- 42. Kanë dhoma që zihen.
- 44. Eshhtë ekulibri në palestër.
- 46. Në krye të jursisë.
- 47. Numri i kuartetit.
- 48. Gjysmë armate.


- VERTIKAL**
- 1. Gjysma e lapsit.
  - 2. Përfundojnë pingul
  - 3. Shkruben për filma.
  - 5. Duhet realizuar.
  - 6. Gabim pa kufij.
  - 7. Portokalli i Stanley Kubrick.
  - 8. Në krye të artistëve.
  - 9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
  - 10. Fleming që krijoi James Bond.
  - 13. Janë binarë.
  - 15. Janë dhoma.
  - 16. Eshhtë i zi... pikant.
  - 17. Institucione Lokale Tiranë.
  - 19. Pagëzoi Shën Palin.
  - 20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
  - 22. Janë pamje nga puna.
  - 26. Janë aksione për... gol.
  - 29. Një fjalë për më vonë.
  - 29. Maria Rilke, shkrimtar.
  - 30. Fillojnë turnin.
  - 32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
  - 34. Eshhtë copë... torte.
  - 35. Mbyllin një tender.
  - 34. Ndo në kufij.
  - 38. Një pëlhurë.
  - 40. Lidh dy brigjet.
  - 41. Një pije piratësh.
  - 43. Fillojnë lehtë.
  - 45. Të fundit në sirtar.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

		2	9			8		3
9	5	4					1	
			2	1				7
	9			6	3		7	8
5			4		8			1
4	3		7	9				2
7				3	9			
	1					7	6	5
8		6			5	2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

9	8	4	3	2	6	1	5	7
1	5	2	4	7	9	6	8	3
6	7	3	5	1	8	2	9	4
2	6	5	1	3	7	8	4	9
4	9	8	2	6	5	3	7	1
3	1	7	8	9	4	5	2	6
7	2	1	9	5	3	4	6	8
5	4	9	6	8	1	7	3	2
8	3	6	7	4	2	9	1	5

*Argëtim filozofik*

- Sa më e thjeshtë është komplikimi i gjërave, aq e komplikuar është thjeshtësimi i tyre.  
 - Kur dy njerëz zihen, fajin e ka ai që është më i mençur.  
 Në një botë ku ju mund të jeni ç'të dëshironi, zgjidhni të jeni vetvetja juaj.  
 - Sistemi politik triumfon sepse është një pakicë bashkuar që vepron kundër shumicës së ndarë.



**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

8 4 1 2 3 4 6 5 3 4 1 4  
 1 2 8 1 5 8 4 7 10 6 4 3  
 10 6 7 2 7 11 6 2 1 4  
 10 7 15 1 12 1 2 3 4 10 1  
 1 12 1 4 3 2 6 4 3 1 2  
 4 2 6 11 3 2 6 4 3 1 14 3  
 1 2 4 16 2 7 16 6 18 1 4 4  
 1 2 8 3 14 3 1 1 1  
 1 19 1 4 11 3 4 2 6 15C  
 8 1 5 4 18 6 2 1 4 3 2 6 1  
 5 16 1 10 6 4 3 4 6 3 19P  
 10 3 15 3 18 6 14 8 14 A

M I K E K M S  
 E K A R O M A K E T  
 K M I L I T A N T E T  
 M A T E M A T I K A  
 P A S A N I K T S  
 E K U A N E T A R E T  
 R E T E B L I R A N I  
 I T R B L A K E L  
 M I A R E D A K E K I  
 E M E T A L E I S  
 T E K E M K U M T  
 M O R A V I A M A E

*Thënie të mençura*

- Përfundimisht shokët janë si gjokset e femrave, disa të vegjël, disa të mëdhenj, disa të vërtetë dhe disa falco.
- Me fuqinë e vullnetit njeriu ndryshon veten e tij. Me fuqinë e dashurisë ndryshon të tjerët.
- Me fuqinë e mendimit ndryshon botën.
- Mendimet e mia mund të kenë ndryshuar, por jo fakti që kam të drejtë.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

